

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7616 E premte 10 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**Kosova po vendoset sërish në axhendën diplomatike dhe media-tike, pas deklaratës së Presidentit Thaçi për korrektimin e kufijve me Serbinë, një ide kjo...**

Vijon në faqen 20

Nga EVA LONDO

**Media dhe kufijtë e rinj të Kosovës. Analizë e konspiracion**



**Opinion** **Ditës**

**Kur njeriu rrëshqet, zakonisht ndodh padashur. Ndoshta edhe qeveria jonë po rrezikon të rrëshqasë me financat e saj publike... padashur: Nota e dhënë pesë...**

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Rrëshqitja fiskale, pakt me djallin?**



Ambasadorja gjermane: Jemi krahe Shqipërisë për anëtarësimin në BE

## Schütz: Gjykata e Lartë e Kushtetuesja të rimarrin aftësitë ligjore sa më shpejt

“Të krijohen këshillat e lartë për plotësimin e vendeve vakante”

Mekanizmi për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është një kolonë mbështetëse e reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri, e cila po mbështetet prej vitesh nga Gjermania”, u shpreh dje për ecurinë e procesit të vetingut, ambasadorja gjermane, Susanne Schütz. “Unë e përshëndes faktin që procesi i vetingut, i nisur në muajin mars, ka përparuar mirë...”

Në faqen 2

## FORMULA E SAKTE SI TE LLOGARISNI MASEN QE DO TE PERFITONI NGA VITET E PUNES

# 2018-2019, JA SI NDRYSHON MOSHA E DALJES NE PENSION

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Pensioni, produkt i viteve të sigurimit dhe pagës. Sa më gjatë, aq më shumë kontribute do merrni



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

**ISH-KRYEPROKURORI**

**Gjykata i refuzon Adriatik Llalës kthimin e pasurive të sekuestruara**

Në faqen 3

**INTERVISTA PER 'GSH'**

**Flet gjyqtarja Çela: Ministria më vlerësoi për Prudentinon, sot më sulmojnë pa të drejtë**

Në faqen 6

**HAPAT QE DO NDIQNI**

**ALUIZNI: Hipoteka, 300 pronarët që kanë gati tapitë në Shkodër, Malësi të Madhe e Pukë**

Në faqen 22

**5 MIJE PERFITUES**

**Lista e 11 me pronarët që u është njohur drejta për kompensimin e tokave të marra në '45**

Në faqen 10-11

### SI E PASTRUAM ZONËN NGA MBETJET E DIKTATURËS



**Ish-ministri: Baza e NATO-s, si u arrestua gjenerali i bazës ajrore**

Në faqen 5

Turistë nga Europa, SHBA e Australia “bujnë” në Korçë: Jemi të befasuar

## Festa e Birrës, mijëra pjesëmarrës mbushin sheshin

Ambasadori rumun: “Birra Korça”, e mrekullueshme, do pi me qejf, por me masë

KORÇË- Nata e dytë e Festës së Birrës ka elektrizuar qytetin e Korçës. Mijëra vetë nga rrethet e ndryshme të vendit dhe jo vetëm kanë “pushtuar” sheshin në krah të stadiumit “Skënderbeu” dhe Pazarin e Vjetër, duke festuar deri në orët e para të mëngjesit të sotëm. Muzika me zërat më të



mirë të skenës shqiptare kanë krijuar atmosferë të ngrohtë për pjesëmarrësit, të cilët e kanë gdhirë duke kërcyer dhe konsumuar “Birra Korça”. Këngëtarët, DJ si dhe shija e birrës së parë shqiptare “Birra Korça” kanë joshur jo vetëm vendasit...

Në faqen 8

## VETINGU NDËRKOMBËTARËT

Ambasadorja gjermane: Jemi krah Shqipërisë për anëtarësimin në BE

# Schütz: Gjykata e Lartë e Kushtetuesja të rimarrin aftësitë ligjore sa më shpejt

"Të krijohen këshillat e lartë për plotësimin e vendeve vakante"

Mekanizimi për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është një kolonë mbështetëse e reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri, e cila po mbështetet prej vitesh nga Gjermania", u shpreh dje për ecurinë e procesit të vetingut, ambasadorja gjermane, Susanne Schütz. "Unë e përshëndes faktin që procesi i vetingut, i nisur në muajin mars, ka përparuar mirë. Falë punës së rëndësishme të Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve dhe përkrahjes së përkushtuar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, u bë e mundur që në fazën e parë të vetingut të verifikohen shumë gjyqtarë dhe prokurorë, madje edhe të nivelit të lartë. Jam e bindur se një proces verifikimi i pavarur dhe me standarde të njëjta do të ndihmojë në forcimin afatgjatë të shtetit ligjor dhe të besimit të shqiptarëve në sistemin e drejtësisë", u shpreh dje ambasadorja Schütz. "Prandaj është e rëndësishme të krijohen këshillat e lartë për plotësimin e vendeve vakante, si dhe Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese të rimarrin sa më shpejt të jetë e mundur aftësinë e tyre ligjore. Në këtë kuptim, Gjermania do të mbështesë edhe Shkollën e Magistraturës në zgjerimin e kapaciteteve të saj arsimore dhe kualifikuese. Gjermania qëndron krah Shqipërisë, duke mbështetur vendin në rrugën drejt negociatave për anëtarësimin në BE", tha Schütz. Një mbështetje e tillë është shprehur edhe nga të tjerë ndërkombëtarë. Dy ditë më parë, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", raporti për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein u shpreh i keqardhur për faktin që opozita e maxhoranca nuk mundën të bien dakord në seancën e fundit të Parlamentit shqiptar, për ndry-

shimet ligjore për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj në Shkollën e Magistraturës. "Kjo është absolutisht e nevojshme për funksionimin e institucioneve. Shpresojmë se kjo do të

bëhet së shpejti", shprehet Fleckenstein në këtë intervistë për "Gazeta Shqiptare". Sa i përket procesit të vetingut, raporti për Shqipërinë në Parlamentin Evropian u shpreh se Shqipëria duhet të jetë krenare

për këtë reformë shumë ambicioze. "Vetingu është thelbësor për të krijuar besim në këto institucione dhe sundimin e ligjit. Në fund të fundit, prova përfundimtare e një reforme të suksesshme duhet të jetë në rezultatet e arritura në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë edhe ndjekjen penale të efektshme dhe dënimet për krimin e organizuar.

Fakti që tashmë ka pasur disa shkarkime dhe dorëheqje vullnetare tregon se vetingu po funksionon", deklaroi Knut Fleckenstein. Sa i përket datës së përcaktuar nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian për çeljen e negociatave me Shqipërinë, Fleckenstein tha se do të dëshironte që ajo datë të ishte më afër.



ambasadorja gjermane, Susanne Schütz

Qytetarët do të dorëzojnë lejen e drejtimit shqiptare e do të marrin atë greke

## Njohja e patentave, hyn në fuqi marrëveshja e firmosur me Greqinë

Marrëveshja mes Shqipërisë e Greqisë për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit të automjeteve ka hyrë në fuqi dhe pritet të lehtësojë ndjeshëm jetën e shtetasve shqiptarë, të cilët punojnë dhe jetojnë në shtetin fqinj, por edhe atyre që udhëtojnë drejt vendit fqinj dhe anasjelltas. Njohja e ndërsjellë e lejeve të drejtimit është një zhvillim pozitiv, pasi do t'u krijojë lehtësi lëvizjeje dhe komunikimi më të mëdha shtetase shqiptarë dhe grekë. Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit mes dy vendeve, marrëveshje që tashmë ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.



Marrëveshja u nënshkrua në maj në Souni, Greqi, nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikolaos Kotzias. Marrëveshja parashikon që qytetarët shqiptarë, të cilët kanë leje drejtimi shqiptare nuk do të kenë nevojë të rifillojnë procedurat e kualifikimit dhe të provës për marrjen e lejes së drejtimit greke, e cila

ka edhe një impakt financiar nga 700 deri në 1000 euro, për çdo leje drejtimi të marrë në Greqi. Qytetarët do të dorëzojnë lejen e drejtimit të marrë në Shqipëri dhe do të marrin atë greke duke u krijuar mundësi të qarkullojnë ose të punësohen si drejtues mjeti në Greqi, me të drejta të barabarta me shtetasit grekë.



### KNUT FLECKENSTEIN

Sa i përket procesit të vetingut, raporti për Shqipërinë në Parlamentin Evropian u shpreh se Shqipëria duhet të jetë krenare për këtë reformë shumë ambicioze. "Vetingu është thelbësor për të krijuar besim në këto institucione dhe sundimin e ligjit. Në fund të fundit, prova përfundimtare e një reforme të suksesshme duhet të jetë në rezultatet e arritura në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë edhe ndjekjen penale të efektshme dhe dënimet për krimin e organizuar", tha ai



## Gjosha: Të rinjtë duan të ikin, domosdoshmëri politika për punësim

Ish-ministria e Integritimit, Klajda Gjosha deklaroi dje se situata e të rinjve në Shqipëri është alarmante. Ajo i referohet sondazhit të fundit të CRCA-së, sipas të cilit 70% e të rinjve kërkojnë të largohen për të jetuar në një nga vendet e BE. "Dhe ajo çka të trondit më shumë është fakti se, edhe pse qeveria është në dijeni të këtij fakti, ajo refuzon paturpësisht të zbatojë Planin Kombëtar të Rinisë që e ka detyrim ligjor t'i përgjigjet çdo pike të saj me përpikëri. Deri në fund të vitit 2017, qeveria nuk shpenzoi asnjë lek për zbatimin e Planit të Veprimit për Rininë. Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri konstaton gjithashtu se qeveria ka dedikuar vetëm 0.01% të buxhetit të shtetit për të rinjtë, për rreth 35% të popullsisë në Shqipëri. Nëse 70% e të rinjve kërkojnë të largohen, nëse profesionistët dhe shtresa e mesme kërkon të largohet, imagjini se si do të ishte Shqipëria e së ardhmes. E nëse kjo nuk quhet emergjencë kombëtare, realisht nuk di se çfarë do të ishte më alarmante se kaq!", u shpreh Gjosha. Ajo thotë se nevoja për politika punësimi dhe arsim cilësor është domosdoshmëri, por mbi të gjitha është detyrim dhe përgjegjësi e çdo qeverie.



Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i paraqiti Komisionerëve Publikë ditën e djeshme rekomandimin për të ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të vendimin e KPK-së për konfirmimin në detyrë të kreut të prokurorit Gentian Osmanit. Magjistrat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, njëkohësisht kandidati për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë u konfirmua në detyrë nga KPK edhe pse rezultoi se nuk justifikonte dot kthimin e një borxhi 20 mijë euro. Komisionerët Publikë, pasi t'u jetë njoftuar vendimi me shkrim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, do ta shqyrtojnë atë krahas rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Prokurori Osmani ka qenë një prej prokurorëve që kërkoi arrestimin e ish-ministrit

Nuk justifikonte kthimin e borxhit 20 mijë euro, KPK konfirmoi Osmanin

## Vetingu, ONM kërkon shkarkimin e prokurorit të çështjes "Tahiri"



Saimir Tahiri për korrupsionin dhe trafikim lëndësh narkotike. Gjatë seancës relatori i çështjes, Roland Ilia, tha se lidhur me pasurinë, ILDKPKI ka dorëzuar një raport me konstatimin se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin. KPK ka kryer një hetim të thelluar në lidhje me gjendjen pasurore dhe burimet e kësaj

pasurie. Sipas KPK Osmanit ka qenë bashkëpunues duke dorëzuar dokumentet dhe deklarimet në kohën e parashikuar. "KPK e konsideron të përfunduar seancën dëgjimore. Në përfundim të seancës së rivlerësimit kjo trupë gjyqësore vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Osmani", deklaroi relatorja

e çështjes Firdes Shuli. Ndërkohë DSIK ka dorëzuar një raport me konstatimin se Gentian Osmani është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Kujtojmë se në seancën dëgjimore Osmani zgjodhi të ballafaqohej personalisht me institucionin e vetingut. Prokurori Osmani kandidoi për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Osmani e ka filluar karrierën në vitin 2003 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe një vit më vonë është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vitin 2014 ai është komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe një vit më vonë ai është kthyer në Prokurorinë e Krimeve të Rënda në Tiranë.

Ish-kryeprokurori nën akuzë për pastrim parash nis përballjen me drejtësinë

# Apeli rrëzon kërkesën e Lallës, pasuria e tij mbetet nën sekuestro

Prokuroria: Pronat janë vendosur si garanci për hetimin

Pas vendimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda për sekuestro preventive të pasurive të paluajtshme me vlerë rreth 1 miliard lekë, në emër të ish-kryeprokurorit, Adriatik Lallës, avokati Sokol Hazizaj ankoi ditën e djeshme këtë vendim. Por Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda ka rrëzuar kërkesën e ish-kryeprokurorit Lallës duke lënë në fuqi sekuestron e pronave të tij. Ditën e djeshme u mbajt seanca e parë për ankimin e sekuestros preventive të disa prej pasurive të Lallës, e cila la në fuqi masën që u vendos në 20 korrik. Vetë ish-kryeprokurori pohoi shkurtimisht se ankoi sekuestrimin e pronave të tij. Mes pasurive të sekuestruara është një apartament në qytetin e Durrësit dhe mbi 22 mijë metra katrore tokë are në Tiranë. Këto sekuestro, sipas Prokurorisë së Krimeve të Rënda, janë vendosur si garanci në lidhje me hetimin që ka nisur ndaj kryeprokurorit Lallës. Fillimisht, hetimet ndaj Lallës nisën kryesisht nga prokuroria e Durrësit, pas dyshimeve se nuk kish të deklaruar të gjitha pasuritë e paluajtshme që dispononte. Më pas, hetimi u transferua tek Prokuroria e Krimeve të Rënda, e cila pas veprimeve hetimore të kryera në bashkëpunim edhe me policinë, u kërkoi gjykatës të sekuestroonte pasuritë e Lallës, si garanci për hetimin që ka nisur. Ndër të tjera Lallës po mer-



Ish-kryeprokurori, Adriatik Lalla

**VENDEMI**  
Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda ka rrëzuar kërkesën e ish-kryeprokurorit Lallës duke lënë në fuqi sekuestron e pronave të tij. Ditën e djeshme u mbajt seanca e parë për ankimin e sekuestros preventive të disa prej pasurive të Lallës, e cila la në fuqi masën që u vendos në 20 korrik. Vetë ish-kryeprokurori pohoi shkurtimisht se ankoi sekuestrimin e pronave të tij.

ret edhe me ankimin e vendimit të Institucionit të Komisionerëve Publikë, ku ky i fundit kërkoi nënshkrimin e ish-kryeprokurorit në procesin e vetingut. Kujtojmë se Komisioneri Publik ankoi vendimin e Komisionit të Posaçëm të Kualifikimit, KPK, për ndërprerjen e vetingut ndaj Lallës. Ish-prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Lalla u vendos nën hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda menjëherë

pas valës së akuzave që u drejtuan atij, sapa dha dorëheqjen nga sistemi i drejtësisë shqiptare. Lalla akuzohet për pastrim parash. Sipas hetimeve të prokurorisë ka dyshime se pasuritë e Adriatik Lallës janë të pajustificuara, ndërsa vlera e tregut të pasurive të paluajtshme kap shifrën e 98.772.000 lekëve. Është hera e parë në historinë e Shqipërisë që një ish-Prokuror i Përgjithshëm vi-

het nën hetim për akuzën e rëndë të pastrimit të parave dhe i sekuestrohet pasuria. Akuzat në fjalë ishin pothuajse e paralajmëruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit kur e motivoi futjen e familjes Lalla në listën e saj të zezë, duke mos i lejuar të udhëtojnë drejt SHBA, me pretendimin për përfshirje në raste të mëdha korrupsioni të ish-kryeprokurorit, gjatë kohës që ka qenë në këtë detyrë.

**PASURITË QË SEKUESTROHEN**

- Apartament banimi, me sipërfaqe 67.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës;
- Tokë arë, me sipërfaqe 4.500 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë;
- Tokë arë, me sipërfaqe 12.300 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë;
- Tokë arë, me sipërfaqe 3000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë;
- Tokë arë, me sipërfaqe 2250 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë;
- Vlera e tregut e pasurive të paluajtshme të mësipërme, në total është në shumën 98.772.000 lekë.

**NJOFTIMI I PROKURORISË PËR SEKUESTRIMIN**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, mbi bazën e akteve të ardhura për kompetencë lëndore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka rirregjistruar procedimin penal nr.65 viti 2018, në ngarkim të shtetasit Adriatik Lalla, ish-Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të hetimeve paraprake të kryera lidhur me këtë procedim penal, në bashkëpunim të ngushtë me policinë gjyqësore në Drejtorinë Hetimore Qendrore,

pranë Departamentit të Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë, janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Si rezultat i veprimeve hetimore të kryera, janë krijuar dyshime të arsyeshme se disa pasuri të paluajtshme në zotërim të shtetasit Adriatik Lalla përbëjnë produkt të veprës penale. Me vendimin nr.179, datë 20.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorisë, vendosja e masës së sigurimit pasurore "sekuestro preventive" për disa prej pasurive të paluajtshme të ish-kryeprokurorit Lalla.

**HETIMI**  
Sipas hetimeve të prokurorisë ka dyshime se pasuritë e Adriatik Lallës janë të pajustificuara, ndërsa vlera e tregut të pasurive të paluajtshme kap shifrën e 98.772.000 lekëve. Është hera e parë në historinë e Shqipërisë që një ish-Prokuror i Përgjithshëm vihet nën hetim për akuzën e rëndë të pastrimit të parave dhe i sekuestrohet pasuria.

# RAPORTI I VETINGUT STATISTIKAT


Instituti i Studimeve Politike, vetingu, publikon përmbledhjen e punës së KPK

## Raporti për komisionerët e vetingut, 3 anëtarët që shkarkuan më shumë gjyqtarë

Drejtuësja e KPK ka dhënë më shumë konfirmime në detyrë

Instituti i Studimeve Politike ka bërë dje, një përmbledhje të punës së deritanishme të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me vendimmarrjen në vetingun e gjyqtarëve e prokurorëve që kanë kaluar deri më tani. Në këtë analizë të ISP zbulohet se kush janë komisionerët më të "ashpër" dhe "më të butë". Bazuar në vendimet e marra në 51 çështje të shqyrtuara nga marsi deri në fillim të gushtit, ISP pas monitorimit të procesit i ka renditur gjykatësit mbi bazë të numrit të çështjeve që kanë shqyrtuar dhe qëndrimin që kanë mbajtur.

Sipas të dhënave të publikuara nga 12 anëtarë, 5 anëtarë të KPK-së kanë dhënë më shumë vendime shkarkimi se sa konfirmimi. Po ashtu analiza e ISP zbulon se nga të dhënat e deritanishme, prokurorët dhe gjyqtarët femra janë konfirmuar në detyrë gati dy herë më shumë se kolegët e tyre meshkuj. Raporti i ISP, i publikuar të enjten po ashtu thekson se pavarësisht pritshmërive "problemi më i madh me të cilin po ndeshet reforma nuk është rezistenca politike apo kritikë nga brenda e jashtë sistemit, por boshllëku i krijuar në fazën e tranzicionit midis procesit të vetingut dhe krijimit të institucioneve të reja, si dhe vonesat e shumta në ecurinë e jetësimit të reformës dhe të institucioneve të reja". Brunilda Bekteshi, Etleda Çiftja, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari, janë anëtarët e KPK-së që sipas ISP-së kanë dhënë më shumë vendime shkarkimi. Lista fillon me Bekteshin që ka votuar për shkarkim në 60 për qind të çështjeve, Çiftja ka vendosur për shkarkimin në 57 për qind të rasteve, ndërsa Pine dhe Sanxhaktari, të cilat kanë numrin më të madh të çështjeve të shqyrtuara, janë shprehur për shkarkimin në 53 për qind të rasteve. Në këtë listë është po ashtu edhe Alma Faskaj, e cila ka mbajtur qëndrim për shkarkimin e gjykatësve apo prokurorëve në 60 për qind të çështjeve ku ka marrë pjesë, por Faskaj ka qenë pjesë e trupave gjyquese në



KOMISIONERËT	VENDIME	NË %	KONFIRMIME	SHKARKIME
XHENSILA PINE	17	12%	47%	53%
VALBONA SANXHAKTARI	17	12%	47%	53%
ETLEDA ÇIFTJA	14	10%	43%	57%
ROLAND ILIA	14	10%	79%	21%
PAMELA QIRKO	13	9%	62%	38%
GENTA TAFI (BUNGO)	12	8%	58%	42%
LULZIM HAMITAJ	11	8%	55%	45%
OLSI KOMICI	11	8%	55%	45%
FIRDES SHULI	11	8%	82%	18%
BRUNILDA BEKTESHI	10	7%	40%	60%
SUELA ZHEGU	9	6%	67%	33%
ALMA FASKAJ	5	3%	40%	60%

vetëm 5 çështje. Në krahnun e "të butëve" është Firdes Shuli e cila në 82 për qind të vendimeve ka qenë pro konfirmimit të gjykatësit apo prokurorit të shqyrtuar. Pas saj me 79 për qind vendime pozitive është Roland Ilia, Suela Zhegu me 67 për qind dhe Pamela Qirko me 62 për

qind. Me më shumë konfirmime se shkarkime janë edhe Genta Tafa (Bungo) drejtues e KPK-së, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici. Nga të dhënat e publikuara nga ISP rezultoi se ka ndërkohë një ndarje të qartë gjinore mes atyre që shkarkohen dhe atyre që kon-

firmohen. Përqindja e gjykatësve dhe prokurorëve burra që ia dalin të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit është shumë më e ulët se ajo e kolegeve të tyre gra. Sipas ISP vetëm 39 për qind e meshkujve gjykatës dhe prokurorë të përfshirë në proces rivlerësimi janë konfirmuar. Përkundrajsisht 69 për qind e femrave gjykatësve dhe prokurorëve kanë kaluar me sukses procesin e vetingut. Ndërkohe sipas ISP megjithëse vendimmarrjet e KPK dhe të strukturave të tjera të rivlerësimit janë të pavarura, "në disa raste ka pasur debate dhe kritika publike nëse vendimmarrjet bazoheshin në standard të njëtrajtshme për subjekte të ndryshme të rivlerësimit dhe nëse ka pasur ndërhyrje nga jashtë në vendimmarrje". Raporti thekson se në të paktën katër raste Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe Komisioneri Publik kanë apeluar vendimet e KPK-së, ndërsa në pesë raste vetë komisioni ka qenë i ndarë duke marrë vendime me shumicë votash. Raporti po ashtu vlerëson ndikimin e krijuar nga zbatimi i reformës në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe mosngritjes së institucioneve të reja. Duke përllogaritur kohën e marrë për rivlerësimin deri tani ISP thotë se emërimet në këto institucione mund të fillojnë në vjeshtë të këtij viti.



### RAPORTI

Raporti i ISP, i publikuar të enjten po ashtu thekson se pavarësisht pritshmërive "problemi më i madh me të cilin po ndeshet reforma nuk është rezistenca politike apo kritikë nga brenda e jashtë sistemit, por boshllëku i krijuar në fazën e tranzicionit midis procesit të vetingut dhe krijimit të institucioneve të reja, si dhe vonesat e shumta në ecurinë e jetësimit të reformës dhe të institucioneve të reja".



### Këshilltari i PD akuzon kryebashkiakun

## Spaho: Veliaj vjedh 14 mln euro me projektin e shkollave me PPP

Këshilltari demokrat në Këshillin Bashkiak të Tiranës, Mateo Spaho ka hedhur akuzë ndaj kryetarit Erion Veliaj. Në një deklaratë për mediat dje, nga selia e Partisë Demokratike, Spaho tha se kryebashkiaku i Tiranës vjedh 14 milionë euro me projektin e shkollave me PPP. Ai tha se përfituesi i parë nga këto politika të Veliajt, është ndërtuesi i shtëpisë së tij tek Kodra e Diellit. Këshilltari demokrat në Bashkinë e Tiranës tha se "Ka ardhur koha që qytetarët e Tiranës t'i japin fund shkatërrimit të qytetit me beton, babëzisë dhe vjedhjes së mbuluar me ngjyra të bukura nga simboli i korrupsionit të Tiranës, Erion Veliaj".

"Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka vendosur të fusë dorën edhe më shumë në xhepat e qytetarëve të kryeqytetit dhe t'i grabisë ata duke përdorur si mburojë fëmijët dhe shkollat. Ai po përgatit dhe po zbaton skemën më të madhe të abuzimit me paratë tona, paratë e taksapaguesve, për t'ua dhënë klientëve të tij dhe klientëve të tutorit të tij Edi Rama", tha Spaho. "Ka ardhur koha që qytetarët e Tiranës t'i japin fund shkatërrimit të qytetit me beton, babëzisë dhe vjedhjes së mbuluar me ngjyra të bukura nga simboli i korrupsionit të Tiranës, Erion Veliaj!", tha ai.

### MINISTRI I FINANCEVE

## Ahmetaj: 38 mijë vende të reja pune dhe 10 mijë biznese me shumë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj iu përgjigj deklaratave të ditëve të fundit dhe akuzave të artikuluara nga opozita për ecurinë e ekonomisë. Ai ka publikuar në faqen e tij në Facebook shifrat që tregojnë ecurinë e punësimit dhe bizneseve të reja të regjistruara në vend, duke sqaruar se vetëm në vitin e fundit janë hapur 38 mijë vende të reja pune, ndërsa bizneset e reja në janar-korrik 2018, janë 10 mijë më shumë. "Ja e vërteta e shi-

frave mbi punësimin, bizneset e reja dhe ekonominë! Qershor 2017-qershor 2018, rezultojnë 38 mijë vende të reja pune në ekonomi. Në shtatë-mujorin e parë të vitit 2018, janë shtuar mbi 10 mijë biznese të reja (efekti neto nga diferenca mes bizneseve të regjistruara rishtazi dhe atyre të çregjistruara). Dhe sa për t'ju kujtuar korbave të dëshpëruar... rritja ekonomike aktualisht është 4.5 herë më e lartë se ajo që gjetëm në 2013!", shkroi Ahmetaj.



Ish-ministri i Mbrojtjes: Si e pastruam zonën nga mbetjet e diktaturës

# Kuçova bazë e NATO-s, Imami: Projekti, ishte gati që në 2011, por e bllokoj PS

## "Pse e arrestuan gjeneralin e bazës ajrore"

Valentina Madani

**I**sh-ministri i Mbrojtjes, Arben Imami përshëndet vendimin e marrë nga Aleanca e Atlantikut Verior, për të modernizuar bazën ajrore të Kuçovës, që mundëson ndërtimin e aeroportit të vetëm të forcave ajrore të Shqipërisë. Por z.Imami thotë për "Gazeta Shqiptare" në një bisedë telefonike se ky projekt ka nisur që në vjeshtën e vitit 2011 dhe sipas tij, PS-ja me ardhjen në pushtet e vonoi për më shumë se 4 vite këtë projekt. Madje, ai përmend arrestimin e gjeneral Syrja Gjokës sapo e majta erdhi në pushtet, ndërsa kishin bllokuar për katër vite projektin e dhënë. Ish-ministri tregon se bashkë me gjeneralin Gjoka inspektojuan zonën, e cila sipas tij ishte në gjendje të tmerrshme prej mbetjeve të kohës së diktaturës, Imami shprehet se u bë një punë shumë e mirë për gjatë atyre viteve të qeverisjes së PD-së për ta shndërruar në aerodrome dhe projekti ishte gati, por PS-ja e bllokoj atë. Gjithsesi, Arben Imami e konsideron hap pozitiv kthimin e saj në bazë të NATO-s, pavarësisht se siç thotë ai, nuk e di konkretisht se çfarë përmban projekti.



Ish-ministri i Mbrojtjes, Arben Imami

**DEKLARATA**

"Projekti ka që në vitin 2011 dhe ne nisëm përgatitjet e para. Kam shkuar edhe vetë në bazë dhe kam parë gjendjen në të cilën ishte aeroporti i Kuçovës dhe si u shndërrua deri në momentin që erdhën socialistët në pushtet", deklaroi ish-ministri i Mbrojtjes.

**NDËRTIMI**

Dikur një nga bazat më strategjike të ushtrisë shqiptare, baza ajrore e Kuçovës ishte jashtë funksioni që prej fillimit të demokracisë, por kur u ndërtua ajo? Punimet për ndërtimin e bazës ajrore në Kuçovë, ku NATO pritet të ndërtojë bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor, filluan rreth vitit 1952.

**ULJA**  
Në 23 prill 1955 në aerodromin e Kuçovës u ul për herë të parë avioni "Mig 17", avioni i cili sot gjendet në qendër të qytetit, pranë Shtëpisë së Oficerëve. Avioni bombardues 'Jl - 28' u ul për herë të parë në këtë aerodrom në korrik të vitit 1957.

**SHKËMBIMI**  
Në hyrje të aerodromit të Kuçovës, me një sipërfaqe prej mbi 300 hektarë janë rënditur 200 avionë rusë e kinezë, që shteti shqiptar i merrte me klering duke u dhënë me gjeneralin Gjoka inspektuar zonën, e cila sipas tij ishte në gjendje të tmerrshme prej mbetjeve të kohës së diktaturës, Imami shprehet se u bë një punë shumë e mirë për gjatë atyre viteve të qeverisjes së PD-së për ta shndërruar në aerodrome dhe projekti ishte gati, por PS-ja e bllokoj atë. Gjithsesi, Arben Imami e konsideron hap pozitiv kthimin e saj në bazë të NATO-s, pavarësisht se siç thotë ai, nuk e di konkretisht se çfarë përmban projekti.



## Baza ajrore e Kuçovës, NATO: Do investojmë 51 milionë euro

**K**ëshilli i Atlantikut të Veriut ka miratuar vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor. Me fondet e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe në partneritet me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, NATO do të investojë mbi 50 milion euro vetëm për fazën e parë të projektit për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës. Lajmi u bë i ditur në datën 4 korrik nga kryeministri Edi Rama në një postim në rrjetet sociale. Kryeministri shkruan se përmes këtij projekti, i cili pritet të nisë brenda këtij viti, Kuçova do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n për furnizim ajror, mbështetje logjistike, mbështetje për policimin ajror si dhe trajnim dhe stërvitje të Aleancës. "Kuçova do të shërbejë njëkohësisht edhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore Shqiptare dhe ky investim strategjik i NATO-s në Shqipëri do të sjellë një standard të ri për Forcat tona të Armatosura. Padyshim, një investim i këtyre përmasave krijon mundësi të reja për zhvillimin ekonomik e social të të gjithë rajonit ku planifikohet ndërtimi i kësaj baze të re ajrore të teknologjisë së fundit", shkruan Rama.

**Z.Imami, NATO ka vendosur të ndërtojë bazën ajrore në Shqipëri, pikërisht në aerodromin e Kuçovës, e cila do të mund të përdoret nga Aleanca për qëllime logjistike, policimi ajror, furnizimi, trajnimi etj. Si e konsideroni këtë projekt?**

Është hap pozitiv, por nuk e di konkretisht se çfarë përmban projekti. Gjithsesi, është një projekt që duhet përshëndetur si mjaft pozitiv.

**Ish-kryeministri Berisha është shprehur se ky projekt u përgatit nga një kompani serioze amerikane, 'Cubik' që në vjeshtën e vitit 2011, si dhe filluan parapërgatitjet për zbatimin e tij. Ju kenë qenë ministër i Mbrojtjes në atë periudhë, ndaj si qëndron e vërteta?**

Po, është e vërtetë. Projekti ka që në vitin 2011 dhe ne nisëm përgatitjet e para.

## Si e fitoi pafajësinë gjenerali Syrja Gjoka

**P**as arrestimit në datën 17 maj 2014, gjykata e Beratit shpalli të pafajshëm gjeneral Syrja Gjokën për akuzat e ngritura ndaj tij nga Ministria e Mbrojtjes për shpërdorim detyre. Gjeneral Gjoka u dërgua në gjyq nën pretendimet se i kishte sjellë shtetit një dëm ekonomik prej 6 milionë lekësh, me prishjen e disa ndërtesave të rënuara nga bazën ushtarake të Kuçovës. Ai ka qenë komandant i kësaj baze ajrore. Hetimi ndaj tij nisi në nëntor të vitit 2013, menjëherë pas ardhjes së PS në pushtet. Gjykata e Beratit nuk provoi asnjë shkelje në këto veprime. Arrestimi i gjeneral Syrja Gjokës u komentua si sulm politik ndaj tij nga drejtuesit e Ministrisë së Mbrojtjes.



Kam shkuar edhe vetë në bazë dhe kam parë gjendjen në të cilën ishte aeroporti i Kuçovës dhe si u shndërrua deri në momentin që erdhën socialistët në pushtet.

**Në çfarë gjendjeje ishte baza ajrore e Kuçovës në vitin 2011?**

Në gjendje tmerrri. I mbërthyer nga papastërtitë dhe mbetjet e kohës së diktaturës nga të gjitha anët e zonës. Rregulluan të gjithë ambientin, kapanonet e gjithçka që ishte e shkatërruar. Ishte në një gjendje të amortizuar. Kam qenë vetë aty, kemi inspektuar zonën dhe kemi nisur nga puna për përgatitjen e bazës deri

në momentin e bllokimit. **Pse u zgjodh pikërisht baza e Kuçovës për NATO-n?**

Kërkohej një zgjidhje afatgjatë për Forcat Ajrore dhe ne projektuan pikërisht bazën e Kuçovës. Aeroporti i Kuçovës është më i sigurti nga ana klimatike dhe marrjen e masave konkrete dhe aerodromi i Kuçovës është tredimensional, ka edhe infrastrukturën tokësore. Ndaj filluan parapërgatitjet për zbatimin e tij dhe ishte gjenerali Syrja Gjoka, që u mor konkretisht me gjendjen e bazës ndaj dhe sapo PS-ja erdhi në pushtet, e arrestoi

atë. Ai u mor me inspektimin e zonës nga ku u bënë përgatitjet e nevojshme për një aeroport rezervë për NATO-n. Turqit kishin një projekt në atë kohë dhe për këtë ka pasur takime dhe bisedime konkretet me ushtarakët e lartë turq për ndërtimin dhe zhvillimin e aerodromit të Kuçovës.

**Z.Berisha ka deklaruar se "ata që demonstrian me portretet të Enverit ditën e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, përzunë kompaninë që bëri projektin dhe si banditë të vërtetë arrestuan gjeneral Syrja Gjokën në mënyrën me banditeske, duke vonuar për së paku katër vite projektin e dhënë"....**

Gjenerali Syrja Gjoka ishte komandant i bazës ushtarake ajrore të Kuçovës dhe u mor posaçërisht me përgatitjet e aerodromit të Kuçovës. Kjo është arsyeja që u arrestua gjenerali në 2014-ën. Gjeneral Syrja Gjoka është marrë posaçërisht me gjendjen e aeroportit, me pastrimin nga rrënojat e vjetra. Është mbajtur disa javë në paraburgim.

Çfarë ndodhi me bazën e Kuçovës në momentin e ndërprerjes së përgatitjeve?

Pas bllokimit të projektit që ishte një punë trevjeçare dhe pothuajse aerodromi ishte gati, nuk e di se çfarë ka ndodhur. Nuk jam në dijeni pas këtij momenti, por projekti i NATO-s është hap pozitiv.

Intervista/ "Më vlerësuan për Prudentinon, sot më sulmojnë pa të drejtë"

# Ministria e Drejtësisë kërkon shkarkimin e saj, gjyqtarja: Pse lirova nga burgu Tauland Manajn

## Herila Çela: Prokuroria nuk më njoftoi se ndaj tij rëndonte një tjetër akuzë

Ina Allkanjari

Vendimi i gjyqtarës Herila Çela lidhur me masën e sigurisë për 28-vjeçarin Tauland Manaj ka shkaktuar reagime të ashpra. Manaj është arrestuar brenda këtij viti për dy vepra penale dhe ka marrë masa sigurie nga gjyqtarë të ndryshëm. Duke shqyrtuar vendimet e dhëna ndaj Manajt, vërehet se masa e sigurisë e dhënë nga gjyqtarja Herila Çela nuk ka lidhje me përplasjen me armë mes të rinjve në Vlorë në 28 shkurt 2018, ku Tauland Manaj mbeti i plagosur, sikundër u përfol në media. E kontaktuar nga "Gazeta Shqiptare", Gjyqtarja Herila Çela shpjegon se mori në dorë një tjetër dosje për Tauland Manaj, kur ky i fundit theu masën e sigurisë arrest në shtëpi dhe u kap në Vlorë në 23 qershor. "Dua të bëhet me dije që po akuzohem se kam caktuar masë sigurie "arrest në shtëpi" për veprën penale të "vrasjes së mbetur në tentativë", ndërkohë që kjo s'është e vërtetë. Në vendimin e gjykatës është çdo gjë e sqaruar, si në vendimin e parë që është për ndalimin dhe caktimin e masës së sigurimit për tri akuzat që janë "armëmbajtje pa leje", "prodhim dhe shitje e lëndës narkotike", dhe "largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", thekson gjyqtarja. Në një intervistë ekskluzive për "GSH" gjyqtarja Çela tregon arsyet e vendosjes së masës së sigurisë ndaj Manajt dhe thekson se prokuroria nuk e kishte njoftuar që ndaj tij rëndonte një tjetër akuzë, pasi në këto kushte ai do të cilësohej "përsëritës i veprës penale". "Është e turpshme të thuhet, se për atë çfarë po flitet unë e mora vesh nga mediat, se ky person ka pasur një procedim tjetër. Kërkesa e prokurorisë është në dosje, unë kam marrë në shqyrtim kërkesën dhe ka qenë vetëm me akuzat që sapo citova", tregon gjyqtarja Çela.

**Ditë e fundit, Ministria e Drejtësisë ka kërkuar publikisht shkarkimin tuaj pas vendimit të dhënë për Tauland Manaj, një person me precedent penal. Ju nga ana tjetër, pretendoni se prokuroria nuk ju ka njoftuar që ndaj Manajt rëndonte një tjetër akuzë. Si qëndron e vërteta dhe pse vendosët masën**



Gjyqtarja Herila Çela

### "arrest shtëpie?"

Dua të bëhet me dije që po akuzohem se kam caktuar masë sigurie "arrest në shtëpi" për veprën penale të "vrasjes së mbetur në tentativë", ndërkohë që kjo s'është e vërtetë. Në vendimin e gjykatës është çdo gjë e sqaruar, si në vendimin e parë që është për ndalimin dhe caktimin e masës së sigurimit për tri akuzat që janë "armëmbajtje pa leje", "prodhim dhe shitje e lëndës narkotike", dhe "largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit". Është e turpshme të thuhet, se për atë çfarë po flitet unë e mora vesh nga mediat, se ky person ka pasur një procedim tjetër. Nuk jam në dijeni fare. Kërkesa e prokurorisë është në dosje, unë kam marrë në shqyrtim kërkesën dhe ka qenë vetëm me akuzat që sapo citova.

**Pse mendon se po ndodh kjo situatë? A ka fakte që ju keni kryer shkelje lidhur me akuzat e ngritura së fundmi ndaj jush?**

Nuk e di, nuk arrij ta kuptoj. Unë kam 20 vite gjyqtare, konkretisht 19 vite e pak, nuk i kam mbushur 20 vite akoma. I kam kushtuar këtij sistemi shpirtin, gjithçka. Kam

Unë bëj gati 20 vite në sistem dhe apeli im është nëse gjykon me drejtësi kurrë s'ka pse të stepesh nga gjithçka jo e mirë që të ndodh. Unë kam zgjedhur të bëj këtë detyrë, i kam dedikuar jetën dhe do ta bëj me pastërti.

punuar me ndershmëri. Asgjë nga ato që është thënë nuk janë absolutisht të vërteta, si nga vendimet që janë dhënë si nga procedimet, si nga çështja e ekstradimit të Albino Prudentinos që e kam ndjekur këtu e vite më përpara.

**Pikërisht për Prudentinon, flitet se ju jeni akuzuar në atë kohë për ekstradimin e tij drejt Italisë...**

Për këtë çështje jam nga të vetmet gjyqtare në Republikën e Shqipërisë që më ka ardhur shkresë falënder-



Faksimilie

### SHKURT

**Maskat tentojnë të grabisin bankën, ikin duarbosh**

**FUSHË KRUIJË** - Dy persona të maskuar kanë tentuar që të grabisin një bankë të nivelit të dytë në Fushë-Krujë. Sipas burimeve nga policia lokale, ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Mësohet se rreth orës 04:00, dy agresorët kanë hapur derën e bankës me një levë dhe më pas kanë hyrë në ambientet e brendshme të bankës. Por, maskat janë detyruar të ikin duarbosh, pasi nuk kanë mundur të hapin kasafortën sepse ka rënë alarmi. Menjëherë blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve.

**Kundërshtuan e goditën shefin e policisë, prangosen dy vëllezërit**

**ELBASAN** - Policia e Elbasanit ka vënë dje në pranga dy vëllezër, pasi kanë kundërshtuar dhe goditur shefin e Policisë së Rendit. Bëhet fjalë për shtetasit Mehmet dhe Ervis Daka, përkatësisht 38 vjeç dhe Ervis Daka. Mësohet se blutë kishin shkuar për kontroll në lagjen "Shënoll" të Elbasanit, pas sinjalizimeve se në këtë lagje lëvizte një person i armatosur. Në momentin që kanë hyrë në lokalin e Mehmet Dakës, policët kanë kërkuar që të gjithë personat e ndodhur në lokal t'i bindeshin urdhrin për kontroll. Ndërkaq, Mehmet Daka dhe vëllai i tij, Ervis kanë kundërshtuar me dhunë shefin e Rendit, A. M. Është dashur përforcimi nga patrulla që i priste jashtë për të neutralizuar e arrestuar më pas dy vëllezërit.

imi nga Ministria e Drejtësisë, sepse e kam bërë në kohë rekord nën kërcënime nga llojet më të ndryshme. Pa diskutuar çështjet e tjera që kam patur dhe i kam përballuar vetë. Nuk më ka ndodhur kurrë të kemi një përplasje të tillë. **Ndaj jush është kërkuar edhe procedim disiplinor, çështje e cila është rikthyer në vëmendje ditë e fundit. Çfarë ndodhi në atë kohë, dhe pse kjo çështje u arkivua?**

Për sa i përket procedimit disiplinor që po përsëritet rëndom dhe në mënyrë shumë të keqe, është e vërtetë që ka filluar një procedim disiplinor ndaj meje, në periudhën kur ka qenë ministër i Drejtësisë Eduard Halimi. Është arkivuar çështja, sepse nuk ka pasur pse të fillonte procedimi. Në

2014 filloi procedimi disiplinor, në lidhje me tri vendime civile pushimi. Pushimi i tre vendimeve civile, nuk ka asnjë pasojë të palës, sepse të pushohet një çështje civile do të thotë që ti mund ta vësh në lëvizje përsëri. Nuk ka të bëjë me zvarritjen dhe dorëzimin e dosjeve, siç po flitet. Unë e kam ankimuar këtë vendim dhe sot vendimin e Gjykatës së Lartë që ka bërë nul çdo gjë.

**Cili është apeli juaj lidhur me situatën e krijuar?**

Unë bëj gati 20 vite në sistem dhe apeli im është nëse gjykon me drejtësi kurrë s'ka pse të stepesh nga gjithçka jo e mirë që të ndodh. Unë kam zgjedhur të bëj këtë detyrë, i kam dedikuar jetën dhe do ta bëj me pastërti.

**Shitje me Ankand të Pare nga Studio Perbarimore L.D.C**

"Ndertese", me siperfaqe 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Vol 5, fq 83, ndodhur ne ZK 3426 me adrese ne Tufine, Tirane. Regjistruar ne Z V R P P Tirane ne emrin e Zyber KUKA. Çmimi fillestar per shitje eshte 3.360.000 Leka.

Data e shpalljes 01.08.2018  
Data e zhvillimit 24.08.2018 deri ne oren 16.00  
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Zyra perbarimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 06 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek juo zyrë perbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandi i I-rë, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK 8603, me çmim fillestar 47.25000 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me çmim fillestar 35938000 lek.

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Dëbtori "CO.BE.IN" s'hpk (NUIS J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Perbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

Tiuali+Ndertese e regjistruar ne regjistrimin hipotekote me nr.pasurie 9268 ne ZK nr 8592, me nr prona 47, me siperfaqe totale 161 m<sup>2</sup>, nga kjo 66 m<sup>2</sup> ndertese me adrese i pariziani ne Shkoder

2. Çmimi me te cilin do te filloje shitja ne Ankand per pasurine e sipershpikuar, eshte ne vleren 2,016,000 ( Dymilione e gjashtembjetejtemije ) Leka.

Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date 15.08.2018 ora 16:16 ne Zyrën e perbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballë Gjyqates se rethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te dorinjen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Bankën BKT dogë Shkoder me nr ligjare 41064051.

# PENSIONET E PLEQERISE PËRLLOGARITJA

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Masa, e bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagën

Voltiza Duro

Të moshuarit që kanë plotësuar moshën e përcaktuar me ligj dhe kenë minimumi 15 vite pune me kontribute mund të përfitojnë pension pleqërie. "Gazeta Shqiptare" publikon sot moshën e daljes në pension për gratë për vitin 2018, 2019 dhe 2020. Aktualisht për vitin 2018-të, moshë e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 8 muaj (rritët për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrin në 67 vjeç). Ndërkohë sipas kësaj llogaritjeje, moshë e daljes në pension për gratë në 2019-ën do të jetë 60 vjeç e 10 muaj, ndërsa në 2020 do të jetë 61 vjeç. Sakaq, burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056). Sipas reformës së re të vitit 2014-të, masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të ketë aplikanti dhe sa më e lartë të ketë qenë paga e tij, aq më e lartë do të jetë masa e përfitimit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se vjetërsia e plotë kontributive për të dyja gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të arritur me 40 vite në vitin 2029.

# Si ndryshon moshë e daljes në pension për vitin 2018 dhe 2019 për burrat dhe gratë

## Formula e saktë për llogaritjen e pensionit të pleqërisë



Foto ilustruese

### KRITERET

Të gjithë ata persona që kanë plotësuar moshën dhe kenë minimumi 15 vite pune me kontribute mund të përfitojnë pension pleqërie. Përkatësisht, burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, ndërsa gratë mbi 60 vjeçe e 8 muaj në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese.

### FORMULA

PP= PS \* vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100\* (shumëzuar) me vite sigurimi\* (shumëzuar) me BV. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

ndryshe paga referuese. Ky është një vendim unik që ka të përcaktuar në disa tabela të veçanta llojin e punës që ka bërë individi nga dita që ka filluar punën deri në ditën që e ka lënë atë. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientet e vet të indeksimit. **KOEFICIENTET E INDEKSIMIT**

Koeficientet e indeksimit janë ata koeficientet që kërkohen që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet ta aktualizojnë ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra t'i heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar të '94-ës, me gjithë indeksat e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë indeksohet sot me një koeficient 8.59. Pra, ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po ta aktualizojmë sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe ky indeks sot është i përkallëzuar, e fillon nga '94 deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientet respektivë. Ndërkohë, pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicion pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë, të cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni.

### MOSHA E DALJES NË PENSION

PËR BURRAT						
Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v 35	
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v

PËR GRATË						
Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v 4m	60v 2m	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v 4m	35v 8m	60v 4m	35v 8m
01.01.2017 - 31.12.2017	57v	35	60v 6m	36v	60v 6m	36v
01.01.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v 8m	36v 4m	60v 8m	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v 10m	36v 8m	60v 10m	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v

Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si

ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht ak-

tiv pas datës 01.01.1994. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën pa ndërprerje ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti '75, kur individi ka filluar punë për herë të parë deri në

2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Në 2007-ën u mor një vendim i Këshillit të Ministrave që quhet "Vendimi i Këshillit të Ministrave për pagën mesatare për bazën e vlerësuar për efekt llogaritje të pensioneve", ose siç quhet





# KUFIRI KOSOVE - SERBI DEBATET

Debati për kufirin, mesazhi i qartë i ambasadorit: Kosova e Serbia duhet ta gjejnë vetë zgjidhjen

Pamela Aliaj

## Ndryshimi i kufijve të Kosovës, Gjermania, Anglia e SHBA dalin kundër: Sjell destabilizim

"Sputnik" zbulon skenarët: Teza e ndarjes së Kosovës, drejt një pakti Trump-Putin

Pas debatit që ka pushtuar këto ditë mbarë opinion publik, por edhe politikën kosovare dhe atë serbe për çështjen e kufirit, një tjetër reagim vjen nga ambasada amerikane në Beograd. Ambasadori i SHBA-ve në Beograd, Kyle Scott pohoi se Kosova dhe Serbia duhet ta propozojnë vetë zgjidhje për marrëveshjen përfundimtare mes tyre. Në një intervistë për "Blicin" serb, Scott u shpreh i gatshëm që SHBA-të të ndihmojnë për marrëveshjen. "Normalizimi i raporteve mes Kosovës dhe Serbisë është vendimtar për stabilitetin e rajonit. Normalizimi do të hapte rrugë për të dyja vendet për anëtarësim në BE. SHBA-të mbështesin fuqishëm bisedimet mes Prishtinës dhe Beogradit. Është koha që shtetet të jenë krijuese dhe fleksibël. Ata duhet të propozojnë një zgjidhje. SHBA-të janë të përgatitur të degjojnë dhe të ndihmojnë këto negociata", deklaroi Kyle Scott. Ndërkohë që nga ana tjetër, Ambasada e Britanisë së Madhe dhe ajo e Gjermanisë në Kosovë kanë thënë se thirrjet për ndryshim të kufijve të Ballkanit mund të sjellin destabilizim. "Ne besojmë se thirrjet për modifikim të kufijve nacionalë mund të jenë destabilizuese", ka thënë ambasada britanike në një përgjigje për Radion Evropë e Lirë. "Ashtu siç kemi qenë gjithmonë të qartë, normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është vendimtar për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e të dyja vendeve dhe rajonit në tërësi. Qeveria britanike beson se kjo duhet të jetë në bazë të njohjes së vendeve të pavarura brenda kufijve të tanishëm. Ne vazhdojmë ta mbështesim dialogun të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme me të cilën përfitojnë të dyja vendet". Ambasada e Gjermanisë ka thënë se shteti më i fuqishëm brenda BE-së është kundër ndryshimit të kufijve. "Ministri i Shtetit, Michael Roth, sikurse edhe ambasadori Heldt në intervistë të ndryshme e kanë bërë të qartë pozicionin zyrtar lidhur me dialogun për normalizim të marrëdhënieve. Me këtë, qëndrimi i Qeverisë Federale të Gjermanisë është i njohur", thuhet në një deklaratë të kësaj ambasade për Radion Evropë e Lirë.



"Korrigjim të kufirit", Berisha publikon dokumentin: Marrëveshje që fitojnë të dyja palët

Ish-kryeministri Sali Berisha u ka qëndruar sërish sot deklaratave të tij se termi "korrigjim kufijsh" midis Kosovës dhe Serbisë është thjesht produkt i kuzhinës së Beogradit. Në një postim në "Facebook", Berisha ka ndarë me ndjekësit një dokument ku sipas tij flitet jo për ndarje apo copëtim të territorit të Kosovës, por për korrigjim të kufijve midis Serbisë dhe Kosovës si dhe për marrëveshje 'win-win' midis këtyre dy vendeve. Sipas këtij dokumenti:

- 1- "Korrigjimi" i kufijve, term që përdor sot Beogradi dhe argatët e tij në Prishtinë nënkupton as më shumë dhe as më pak se sa t'i kalojnë Republikës së Serbisë katër komuna, konkretisht Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku.
- 2- Kjo, sipas kuzhinës së Beogradit do të ishte një marrëveshje 'win-win', pra që do të fitonin të dyja palët.
- 3- Në firmosjen e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë Edi Rama! Mendoj se ky dokument nxjerr lakuriq argatët e Beogradit, që përpigjen të mashtrorin shqiptarët me spekulime semantike të përgatitura në kuzhinën e kryeqendrës së Serbisë dhe të servurura në takime obscure të argatëve të saj shqipfolës albanofob".



### AMBASADA ANGLEZE

"Qeveria britanike beson se kjo duhet të jetë në bazë të njohjes së vendeve të pavarura brenda kufijve të tanishëm. Ne vazhdojmë ta mbështesim dialogun të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme me të cilën përfitojnë të dyja vendet".



### AMBASADA GJERMANE

"Ministri i Shtetit, Michael Roth, sikurse edhe ambasadori Heldt, në intervistë të ndryshme e kanë bërë të qartë pozicionin zyrtar lidhur me dialogun për normalizim të marrëdhënieve. Me këtë, qëndrimi i Qeverisë Federale të Gjermanisë është i njohur", thuhet në një deklaratë të kësaj ambasade për Radion Evropë e Lirë.



### PORTALI RUS "SPUTNIK"

"Ndarja e Kosovës do të shkundë dy shtete të tjera në Ballkan, pesë shtete të BE-së dhe disa nga fuqitë e mëdha botërore. Nëse do të ketë një standard të ri për Kosovën, do të ketë ndarje edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe në Maqedoni. Ç'ka duket hapur se pazari që pritet të mbyllet në shtator në bisedimet finale për Kosovën do të jetë i 'rëndë'".

hur", thuhet në një deklaratë të kësaj ambasade për Radion Evropë e Lirë. Roth dhe Heldt kanë thënë më herët për mediat e Kosovës, se ndarja e kësaj të fundit dhe lëvizjet e kufijve janë shumë të rrez-

ikshme dhe mund ta destabilizojnë të gjithë rajonin e Ballkanit. Edhe pse ambasada ruse ka reaguar fuqishëm pas një shkriimi se propozimi i Hashim Thaçit për korrigjim të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë

është biseduar nga Trump dhe Putin në Helsinki, portali i Kremlinit jep një version dramatik të variantit që po "djeg" edhe më shumë politikën në Ballkan në këto ditë të nxehta gushti. "Sputnik" ka pub-

### Vuçiq: Jam dakord për ripërcaktim të kufijve me Kosovën

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar sot se pajtohet për ripërcaktim të kufijve me shqiptarët në Kosovë. "Unë pajtohem dhe kjo është politika ime, për ridefinim të kufijve me shqiptarët. Kështu që si të kemi territorin për të cilin nuk dihet se kush dhe si e trajton dhe çfarë i takon dikujt. Kjo është gjithmonë potencial për përlëshje", ka thënë Vuçiq. Ai ka shtuar se nuk mund të flasë se për çfarë po bisedon me shqiptarët e Kosovës, sepse kjo do të zbulonte kartat e Serbisë në bisedime, shkruajnë mediat kosovare. Vuçiq ka sqaruar edhe se marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë një pako gjithëpërfshirëse, e cila nuk është aq e lehtë dhe e thjeshtë sa disa e mendojnë.

likuar një analizë të gjatë ku thekson se: "Ndarja e Kosovës do të shkundë dy shtete të tjera në Ballkan, pesë shtete të BE-së dhe disa fuqitë e mëdha botërore. Nëse do të ketë një standard të ri për Kos-

ovën, do të ketë ndarje edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe në Maqedoni. Ç'ka duket hapur se pazari që pritet të mbyllet në shtator në bisedimet finale për Kosovën do të jetë i 'rëndë'".

Lista e dytë me pronarët që do të kompensohen për tokat e sekuestruara në '45-ën

Ornela Manjani

# Buxheti, 15 miliardë lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë vendin

## ATP ka miratuar kompensimin për dosjet 2001-2014

Qeveria ka miratuar një fond prej 15 miliardë lekësh, të cilat do të shpërndahen për të paktën 5 mijë pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit të pronës dhe s'kanë marrë deri tani asnjë këst. Fondi është i ndarë në tri vite 2019-2022, i cili rritet progresivisht vit pas viti. Në projektbuxhetin afatmesëm është miratuar fondi për vitin 2019 në vlerën 4,9 miliardë lekë, për vitin 2020 në vlerën 5,3 miliardë lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 5,4 miliardë lekë. Sipas ligjit në fuqi, pronarëve që u është njohur e drejta për kompensim do të marrin 20% të vlerës në lekë dhe pjesën tjetër 80% kompensim me

tokë. Ndërkohë pronarët mund të aplikojnë për të përfituar nga skema për pagesa të përshpejtuara. **TRI AFATET**  
Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqind-

ja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht ren-

dit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i

kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit finan-

ciar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

### PËRFITUESIT NË TË GJITHË VENDIN

467	Berat	Gëzim Gjoni	376,208
468	Berat	Gëzim Gjoni	532,149
469	Berat	Gëzim Gjoni	428,838
470	Berat	Gëzim Gjoni	95,514
471	Berat	Gëzim Gjoni	504,860
472	Berat	Arben Shekmbi	
473	Berat	Tahir Këlliçi	
474	Berat	Haki Lamçe	3,139,313
475	Berat	Brahim Ali Jaho	1,229,048
476	Berat	Syrja Dollani	3,056,123
477	Berat	Tomorr Sahillari	4,862,131
478	Berat	Irfan Refat Molishti	0
479	Tiranë	NEXHAT STURÇE	
480	Tiranë	Seid Terhani	1,330,147
481	Durrës	Hajrije Krasniqi	4,094,000
482	Durrës	Emin Kosturi	42,000
483	Durrës	Rexhep Gobja	
484	Durrës	Frano Koka	
485	Durrës	Frano Koka	
486	Durrës	Frano Koka	
487	Durrës	Frano Koka	
488	Tiranë	VATHE VRAPI BIZHDILI	0
489	Tiranë	Avdi Dedej	147,392
490	Tiranë	DALIP HOXHA	3,136,000
491	Tiranë		54,847,611
492	Korçë	Petrit Basha	196,600
493	Korçë	Njazi Hoxhallari	
494	Korçë	Gaço Cingo	211,036
495	Korçë	Gaço Cingo	3,230,402
496	Durrës	Drita Gjinali	
497	Berat	Jorgaq Koroveshi	-10,501,049
498	Berat	Andrea Konstandin Bendi	64,200,400
499	Berat	Polikseni Nikolla Shyti	-33,025,716
500	Berat	Jani Vangjel Kuço	-13,308,159
501	Berat	ZYMBYLE MYFTARI	623,000
502	Berat	Nexhmedin Pilafi	-22,099,912
503	Berat	Hasan Tare	31,253
504	Berat	Bajram Dalipi, Hysen Dalipi	1,208,482
505	Berat	Bajram Dalipi, Hysen Dalipi	
506	Berat	Fetah Jaho	7,915,565
507	Tiranë		4,705,120
508	Berat	Anastas Vasil Xhymertaka	-45,532,543
509	Berat	Fatime Hyraj (Xhasti)	2,704,067
510	Berat	Ramadan Haxhi Isufaj	-37,919,789
511	Dibër	LUTFI DODA	1,164,732
512	Berat	Riza Kaci	
513	Elbasan	ERMIOLA DEMIRI	102,838
514	Lezhë	Kol Prendush Qushku	
515	Lezhë	Ahmet Reçi	4,518,341
516	Fier	Aleks Gjoni	910,707
517	Fier	Aleksandër Vesho	4,919,065
518	Fier	Gjergji Dhima	4,616,266
519	Shkodër	Shtjefen Nika	136,414
520	Elbasan	HAJDAR MURRACI	0
521	Lezhë	Gjovalin Shkorreti	31,811,098
522	Shkodër	Shefik Jubica	6,273,094
523	Korçë	Hysen Beshiri	
524	Korçë	Myfit Guxholli	3,759,674
525	Korçë	Hamdi Xhiani	5,248,150
526	Korçë	NESTI DUDO	569,883
527	Korçë	Shaban Kocibelli	
528	Korçë	Gaço Papadhopuli	2,279,567
529	Korçë	Verzilet Qazimllari	2,346,004
530	Korçë	Gaço Cingo	1,600,410
531	Korçë	Skënder Sherif Çekiçi	486,238
532	Korçë	Hasan Sami Starova	594,847
533	Korçë	Omer Ruzhdilbi	194,813
534	Korçë	Shpëtim Ahmet Çollaku	26,395
535	Kukës	Ismail Muharrem Vatoci	755,856
536	Kukës	Halit Hamez Mustafaj	3,723,532
537	Kukës	Fadil Hasan Mustafaj	481,029
538	Shkodër	Zuke Mujaj	212,817
539	Shkodër	Daut Mema	5,266,713
540	Shkodër	Prek Geg Marku	312,798
541	Korçë	Enver Capollari	
542	Kukës	Rame Sali Dauti	193,581
543	Kukës	Imer Ali Bajraktari	877,833
544	Kukës	Arif Syl Mehmetaj	187,164
545	Kukës	Muhamet Halit Jaku	
546	Fier	Vangjel Dano	4,799,088
547	Fier	Feride Berisha	243,954
548	Fier	Myrvete Zyka	1,090,821
549	Fier	Ervehe Bozo	389,583
550	Fier	Fuat Hamitaj	2,313,946
551	Fier	Haxhi Koçiaj	1,599,696
552	Fier	Veledin Kananaj	4,790,518
553	Elbasan	ZIBUSH JAUPI	-3,505,993
554	Elbasan	FATBARDHA MUCA	-8,148,589
555	Korçë	Sotiraj Pine	1,344,000
556	Berat	Qani Zaimi	
557	Berat	Qani Zaimi	1,175,897
558	Berat	Ali Cufe	645,408
559	Vlorë	Zeqir Basha	1,028,533
560	Vlorë	Petrit Laze	462,769
561	Vlorë	Bajram Çela	223,158
562	Vlorë	Thoma Llambo	
563	Gjirokastrë	Spiro Krokari	3,879,263
564	Berat	Yzedin Faik Braushi	2,335,556
565	Kukës	Halit Jashar Jaku	606,570
566	Shkodër	Mehmet Bekteshi	1,214,089
567	Shkodër	Maje Xhelili	915,384
568	Shkodër	Nazmije Selo Llazani	4,834,248
569	Durrës	Beqir Shtyra	
570	Durrës	Eleni Kafaja	
571	Durrës	Ramazan Vrioni	
572	Durrës	Llazar Shani	9,668,000
573	Durrës	Klieri Çika	
574	Durrës	Ibrahim Metani	
575	Gjirokastrë	Reso Harmova	951,572
576	Gjirokastrë	Mihal Stefanidhi	
577	Gjirokastrë	Sofia Noto	-307,998
578	Gjirokastrë	Fatos Telhaj	
579	Gjirokastrë	Barije Late	879,340
580	Korçë		61,000
581	Korçë	Ridvan Shehu	88,650
582	Korçë	Anesti Pundo	
583	Korçë	Lytifi Mero	
584	Kukës	Shaqir Elmaz Avdia	390,609
585	Lezhë	Ded Toma	
586	Korçë	Kritaç Shkodrani	42,039
587	Shkodër	Brahim Bekteshi	
588	Kukës	Haxhi Ibrahim Beraj	2,271,095
589	Durrës	Selim Plaku	11,214,000
590	Korçë	Emil Mborja (Venxha)	1,366,292
591	Korçë	Sotiraj Kostandini	59,955
592	Korçë	Lorenç Glozheni	539,595
593	Korçë	ILIA SAMARA	561,410
594	Shkodër	Gjergj Mundia	386,607
595	Shkodër	Ragip Malja	754,765
596	Shkodër	Sabah Hamid Sukaj	854,359
597	Shkodër	Jonuz Jupl	1,015,466
598	Korçë	Mihallaq Tona	4,909,788
599	Berat		5,284,806
600	Vlorë	Kujtim Myrtaj	158,852
601	Vlorë	Sherif Metaj	3,783,674
602	Vlorë	Kozma Pulaj	1,938,688
603	Berat	Neki Poçari	360,587
604	Berat	Nazmi Hajderi	1,292,173
605	Berat	Ulsi Kadriu	616,680
606	Berat	Ulsi Kadriu	1,629,912
607	Berat	Hekuran Balliu	2,846,549
608	Berat	Muharrem Asim Lybesha	4,033,396
609	Fier	Vangjel Dano	-73,283,030
610	Fier	Fatmir Nezha	
611	Korçë	Samir Plasa	146,462
612	Korçë	Ilirjan Rapo Veli	61,954
613	Korçë	Shefqet Zagorçani	300,917
614	Korçë	Bajram Kadri Bono	98,826
615	Kukës	Xhemal Dervishi	98,826
616	Kukës	Shpëtim Mahmut Nika	1,213,021
617	Kukës	Hamit Sahit Nika	1,213,021
618	Durrës	Ahmet Qerimi	3,176,000
619	Shkodër	Met Çovani	325,493
620	Shkodër	Abdullah Dul Lika	640,282
621	Durrës	Tahir Shehi	4,980,300
622	Durrës	Tomorr Kokomani	
623	Elbasan	ISMETE GRIPSHI	
624	Korçë	Arjan Starova	7,852,514
625	Shkodër	Çezar Burhan Bekteshi	1,331,657
626	Shkodër	Gani Zalli	1,273,377
627	Shkodër	Ndoc Kola	307,638
628	Durrës	Ganimete Mustafa Kalemli, Luljeta Mustafa Murati	1,227,000
629	Durrës	Myftar Hoxha	160,440
630	Kukës	Ali Niman Morina	409,940
631	Kukës	Hasan Imer Leka	768,818
632	Gjirokastrë	Muhamet Kasini	244,393
633	Gjirokastrë	Kosta Goxhari	252,825
634	Gjirokastrë	Rakip Këlliçi	
635	Gjirokastrë	Ndreko Keçi	168,803
636	Gjirokastrë	Pëllumb Neviri	
637	Gjirokastrë	Luan Islamaj	9,520,187
638	Gjirokastrë	Emilia Bënja	
639	Fier	Namik Sharka	
640	Fier	Misir Tafa	11,005,640
641	Fier		1,464,644
642	Fier	Xhevaire Kamsi	3,113,066
643	Fier	Astrit Haxhiu	
644	Fier	Sadush Çanaku	
645	Fier	Vath Tushe	
646	Korçë	NESTI DUDO	423,606
647	Korçë	Suat Hasi	116,730
648	Korçë	Sotiraj Lubonja	0
649	Korçë	Rafail Vasil Kalço	18,982,574
650	Korçë	Gurtali Sterkeshi	0
651	Korçë	Shaban Gurtali Doko	0
652	Durrës	Qemal Çausi	
653	Durrës	Brahim Xhemal Zalla	
654	Durrës	Adem Xhaferr Zalla	
655	Durrës	Adem Xhaferr Zalla	
656	Korçë	Remzi Cuke	720,317
657	Korçë	Remzi Cuke	150,066
658	Korçë	FETIE KOKONA	180,079
659	Shkodër	Haxhi Hider Shejza	899,341
660	Shkodër	Zyhdë Man Zagani	366,590
661	Shkodër	Nadiren Vjerdha	3,481,531
662	Korçë	Yiber Kushe	2,178,107
663	Shkodër	Jakup Dimnaku	864,094
664	Berat	SEFEDIN RRAPUSHI	123,483
665	Berat	Engjell Dardha	4,803,373
666	Berat	Veri Satka	
667	Berat	Veri Satka	748,615
668	Berat	Bilo Bregasi	270,119
669	Berat	Ali Çela	
670	Berat	Ali Çela	392,869
671	Shkodër	Ramiz Hasmaga	1,029,384
672	Vlorë	Agron Veitaj	4,259,332
673	Vlorë	Qemal Yzeiri	1,967,608
674	Vlorë	Njazi Xhafa	1,325,543
675	Vlorë	Edison Musaraj	694,528
676	Vlorë	Eqerem Islami	1,616,188
677	Vlorë	Ilir Haxhira	405,178
678	Shkodër	Enrik Angjelin Suma	2,231,839
679	Kukës	Bajram Rustem Popa	117,372
680	Kukës	Hamdi Ibrahim Memia	397,250
681	Korçë	Zyber Dervishi	
682	Fier	Brahim Metaj	5,914,747
683	Korçë	Nazmi Demiri	394,623
684	Korçë	Sotira Nane	1,549,778
685	Korçë	Margarita Plasa	47,376
686	Korçë	Ramadan Nure	0
687	Korçë	Gaço Bice	418,339
688	Korçë	Saip Biba	147,407
689	Korçë	Haxhie Shkullaku	129,636
690	Lezhë	Nikolla Leka	2,698,033
691	Shkodër	Fiqirete Bleta	7,896,420
692	Shkodër	Sadik Jusufaj	872,361
693	Shkodër	Prenda Prek Pjetrani	2,671,363
694	Shkodër	Gjon Tom Gjonaj	1,046,833
695	Shkodër	Shtjefen Gjok Leka	3,489,444
696	Korçë	Nikollaj Kola	586,725
697	Korçë	Kristaq Terpo	101,775
698	Korçë	Bexhet Musaraj, Hava Musaraj	7,882,314
699	Korçë	Skender Dervishi	1,350,000

700	Korçë	ENGJELLUSH ÇELA	490,728	6,763,095	1,015,974	651,882	
701	Shkodër	Mariken Gjonej	1,483,014	63 Korçë Ibrahim Karamuco	172,075	211 Korçë Zyfer Zyfi	258,750
702	Shkodër	Rexhep Bekteshi	369,299	64 Korçë Kostanica Pandeli Cale	2,943,312	212 Korçë Merjeme Shkemb	594,397
703	Shkodër	Mark Bishaj		65 Korçë NATASHA VRETO	37,090	213 Korçë Thimi Tile	345,730
704	Shkodër	Mark Ndue Simoni	1,853,282	66 Shkodër Gjergj Shuk Hila		214 Shkodër Shefqet Zeneli	
705	Shkodër	Pjeter Pjetri	591,267	377,302		1,901,333	
706	Tiranë	Sejdim Nuredin Skupi	123,375	67 Shkodër Zeferina Suma		215 Korçë Lida Papailia ( Palloi )	1,439,829
707	Korçë	Gjergji Shkurti	73,561	1,378,923		216 Berat Xhevahir Hekuran Lleshi	
708	Shkodër	Lek Ndue Nika	58,157	68 Korçë PAVLLO SKENDI	292,669	217 Shkodër Haki Hysja	936,738
709	Berat	Dallëndyshe Shalësi		69 Korçë Koli Stefani	85,253	218 Kukës Ruke Nuhi Tobli	497,588
710	Berat	MUSTAFA XHERIMEJA	416,379	70 Korçë Violeta Stefani	4,264	219 Berat RUSET SALLIASI	306,768
711	Berat	Sybi Palikeshiti	543,758	71 Korçë HEKTOR FRASHERI	2,998,373	220 Berat	1,421,678
712	Berat	Toli Gori Vangjeli	488,938	72 Korçë Fiqiri Myslim	113,685	221 Berat Novruz Hadaj	5,916,240
713	Berat	Mustafa Alush Xherimeja		73 Korçë Stavri Gulimaci	519,977	222 Berat Shaban Llangozi	2,103,223
714	Gjirokastrë	Eva Rami	574,374	74 Korçë Dhori Mizaku	1,998,609	223 Kukës Skender Xhemali Gjana	280,927
715	Gjirokastrë	Skënder Bejleri	581,574	75 Korçë Kristaq Bimbli	467,466	224 Kukës Ali Doci	845,836
716	Shkodër	Luce Jaku	903,517	76 Korçë Dhimiter Kocaqi	1,386,605	225 Kukës Kujtim Haxhi Dushaj	954,048
717	Shkodër	Bec Oso Seli	1,018,585	77 Shkodër Jak Ndue Lleshi	137,422	226 Kukës Bajram Haxhi Ymeraj	38,346
718	Lezhë	Vitore Anton Leshi		78 Shkodër Njazi Ethemi	3,196,894	227 Vlorë Bujar Osmenaj	575,108
719	Vlorë	Koçi Bombaj	710,351	79 Shkodër Mark Luca (Bukaqari)	1,067,356	228 Vlorë Mihal Nerëxhi	
720	Vlorë	Sezai Hoxha	1,158,620	80 Shkodër Jozef Kakariqi	1211,705	229 Vlorë Jorgji Kafria	811,404
721	Vlorë	Andrea Dhimitri	871,962	81 Korçë Rosel Dodona	469,700	230 Berat Refat Rexhep Lapardhaja	
722	Vlorë	Ksenofon Bala	73,814	82 Korçë Vera Pojani	232,804	5,267,535	
723	Korçë	Nevruz Sulstarova	102,979	83 Korçë Emel Pojani	3,455,100	231 Vlorë Mitre Çapoj	951,997
724	Tiranë	ELISE KUQALI	39,578,679	84 Korçë Petrit Hasa	232,804	232 Korçë Miti Koli Note	420,485
725	Korçë	Zydi Lime	606,582	85 Shkodër Zef Ndoka	201,388	233 Korçë Leka Jorgji Note	406,827
726	Elbasan	HALIT SHASHAI	1,894,270	86 Shkodër Sofije Zagani		234 Korçë Ramadan Caka	522,119
727	Shkodër	Adem bala	309,065	87 Shkodër Hasan Bekteshi	2,436,188	235 Korçë Ali Tefik Orozcka	365,243
728	Shkodër	Adem Bala	741,507	88 Korçë Gaqi Leonidha Taro	7,639,375	236 Korçë THOMA DODE	596,756
729	Shkodër	Zyhra Bushati	174,472	89 Korçë Kostandin Shapo	3,361,325	237 Korçë Oresti Prodan	1,734,657
730	Shkodër	Gjovalin Preka	149,548	90 Korçë Komuniteti Bektashian Korce	618,300	238 Korçë Aida Loshi	366,633
731	Shkodër	Sofije Kerpalla	1,535,355	91 Korçë Komuniteti Bektashian Korce	400,500	239 Korçë Ibrahim Çepo	1,159,660
732	Shkodër	Aishe Tuzi	581,574	92 Gjirokastrë Kostandina Cici	1,510,409	240 Korçë Miti Toqe	289,640
1	Korçë	Gurtali Bashllari	291,388	93 Gjirokastrë Drasa		241 Korçë VERXHIL BOBA	3,000,426
2	Korçë	Satber Shule	486,145	94 Gjirokastrë Nuzet Reso	987,956	242 Shkodër Maria Cungu	
3	Kukës	Fejzi Kamber Nika	938,151	95 Gjirokastrë Frida Bozgo	470,455	73,327	
4	Kukës	Selim Rexh Hoxha	253,300	96 Gjirokastrë Engjell Harshova	908,996	243 Shkodër Selaudin Bekteshi	
5	Kukës	Ali Man Kojeli	1,483,585	97 Gjirokastrë Shega Lonari	185,706	244 Shkodër Arben Kuçi	
6	Kukës	Albert Ismail Zejnelli	1,255,036	98 Gjirokastrë Nerzet Idrizi		245 Shkodër Bashkia Islamike Xhamija Mes	
7	Korçë	Andon Cobani	243,595	853,147		246 Shkodër Enis Boleitini	
8	Korçë	Donika Stasa	1,108,640	99 Kukës Haxhi Ibrahim Ahmetaj		256,643	
9	Kukës	Isuf Shem Cenaj	710,172	100 Shkodër Gjergj Bicaqi		247 Gjirokastrë Mejreme Karralliu	
10	Shkodër	Selamije Maci	144,518	73,509		2,601,736	
11	Shkodër	Ferid Faik Zagani	45,482	101 Tiranë LULJETA DERJAJ	1,645,000	248 Tiranë QAMIL SHKRETA	2,651,152
12	Korçë	Harilla Lame	815,968	102 Gjirokastrë Irene Kurto		249 Tiranë	6,089,427
13	Shkodër	Nikoll Pjetri, Prende Pjetri	379,677	103 Gjirokastrë Mehmet Gurga		250 Korçë Servet Furxhi	4,847,646
14	Kukës	Sherif Adem Gjoni	849,244	1,039,954		251 Korçë NIKOLLAQ KOLE	3,496,049
15	Gjirokastrë	Thanas Bukvalla	280,315	104 Gjirokastrë Ferro Gushi		252 Korçë THIMI VESHI	60,768
16	Gjirokastrë	Petro Xherahu		577,752		253 Korçë NEIM TOROLLARI	147,921
17	Lezhë	Xhavid Brajha	-479,754	105 Gjirokastrë Foto Lici	671,293	254 Korçë Myrteza Musallari	189,864
18	Shkodër	Qazim Trashani	794,736	106 Gjirokastrë Spiro Nika	3,235,411	255 Kukës Isa Rexhep Brahimaj	590,621
19	Shkodër	Tef Gjonej	794,338	107 Gjirokastrë Florian Blloca		256 Durrës Pranvera Kapxhiu	-3,897,450
20	Shkodër	Bukurije Thaci	303,740	134,259		257 Shkodër Fuat Kamata	87,720
21	Shkodër	Simon ; Pal Haxhari	2,096,260	108 Gjirokastrë Jani Pilo	385,168	258 Shkodër Emin Lohja	
22	Shkodër	Haxhi Murat Dinja	1,204,524	109 Gjirokastrë Dhimiter Nasto		219,647	
23	Korçë	Urim Pellumbi	924,271	308,134		259 Shkodër Ismail Smailji	769,358
24	Gjirokastrë	Arben Memo	1,015,796	110 Korçë Ramadan Agolli	677,000	260 Shkodër Muharrem Shkja	
25	Gjirokastrë	Koco Pasko	474,038	111 Korçë XHELADIN PILLATI		16,028,730	
26	Lezhë	Dod Miri	656,937	112 Korçë Bilal Hysi	200,000	261 Shkodër Dode Hila	526,974
27	Tiranë	ADRIATIK ISLAMI		113 Korçë Admir Bitincka	200,000	262 Durrës Muhamed Gjyzeli	14,223,000
28	Korçë	PERPARIM HYSENI	1,032,449	114 Korçë Bardhyl Hysi	200,000	263 Durrës Vlash Lojja	
29	Korçë	Vladimir Sula	213,567	115 Korçë Bardhyl Aliko	147,096	264 Korçë At Pandi Plaku	641,608
30	Korçë	Evri Papejani	423,196	116 Tiranë Hava Katroshti, Kaje Bardhi		265 Korçë Gezim Gegolli	139,622
31	Korçë	EFIGJENI TRAJDHI	293,836	4,935,000		266 Korçë Muharrem Alicollari	291,802
32	Korçë	AGIM PODA		117 Korçë Muharrem Dikolli	456,412	267 Tiranë GJEÇI	699,319
33	Shkodër	Bardhyl Brahimi	936,698	118 Korçë Ali Petruti	265,235	268 Tiranë HASAN BRAHJA	
34	Shkodër	Gjergj Nikolle Lakaj	852,176	119 Korçë Komuniteti Bektashian Korce		269 Fier Agron Bare	2,110,177
35	Shkodër	Lule Prendi (Alija)	45,170	400,000		270 Gjirokastrë Karafil Kotori	3,003,675
36	Shkodër	Bajram Llluka	4,440,640	120 Gjirokastrë Jani Boti	335,646	271 Gjirokastrë Spiro Malo	266,148
37	Shkodër	Sejdi ; Bajram Llluka	990,818	121 Gjirokastrë Elpidha Kacifa (Mastaka)	335,646	272 Gjirokastrë Stefan Karamano	
38	Korçë	Fejzi Kambolli	0	122 Berat BUKUROSHE XHAMXHIU		273 Tiranë RUKIJE KACULI	27,079,018
39	Berat	Begdash Alushani	625,564	973,980		274 Tiranë Mehmet Gjini	-5,005,137
40	Berat	Adem Hebibasi	1,938,964	123 Berat LLAZAR ZIU	805,551	275 Gjirokastrë Dhimitër Komata	
41	Berat	Avdulla Asim Laze, Xhemal Gani Laze		124 Berat Nujar Daja	2,830,985	276 Korçë Osman Ramolli	
42	Gjirokastrë	Hiqmet Hoshe	135,995	125 Berat Qazim Myslim Ago	1,361,822	277 Korçë Zane Agolli	1,085,000
43	Gjirokastrë	Grigor Bezati	609,478	126 Berat Dibe Kadri Çorollari	184,440	278 Korçë Agim Bejko	174,009
44	Gjirokastrë	Shqipë Kikino	1,090,038	127 Berat Bujar Daja		279 Korçë Shpresa Toro	185,218
45	Gjirokastrë	Eflohia Thano	167,079	128 Berat Hajredin Qerim Muhametaj		280 Shkodër Latif Deltina	
46	Gjirokastrë	Burhan Xhaxhiu	2,752,642	1,365,366		1,520,848	
47	Gjirokastrë	Enver Mersini	480,838	129 Berat Faik Hoxha		281 Shkodër Zef Rroku	1,596,890
48	Gjirokastrë	Musim Gorica	1,287,786	130 Berat Alush Sali Qereshniku	5,282,304	282 Korçë Xhevit Ibi	63,277
49	Gjirokastrë	Spiro Kristo	41,215	131 Korçë Maksi Pengo	155,501	283 Korçë Myftnia Pogradec	2,531,052
50	Gjirokastrë	Spartak Spahiu	349,700	132 Korçë Suzana Kadzadej	558,455	(vijon)	
51	Gjirokastrë	Selfo Bac	209,820	133 Shkodër Shpend Ahmetaj			
52	Gjirokastrë	Bashkim Bakiri	2,596,387	124,292			
53	Gjirokastrë	Sulo Daci	1,457,085	134 Shkodër Viktor Gjoka			
54	Gjirokastrë	Harrilli Malta	200,453	135 Shkodër Simon Gjon Rroku			
55	Berat	Safet Sadik Qorri	830,025	1,636,964			
56	Berat	Safet Sadik Qorri	444,064	136 Shkodër Bajram Beqi			
57	Berat	Zybejde Fetah Petritaj	1,022,291	247,600			
58	Vlorë	Ilija Gjoka	-1,705,824	137 Shkodër Lazer Hamxhari			
59	Vlorë	Andrea Diamanti	182,399				
60	Vlorë	Ibrahim Gjonaj	2,427,920				
61	Vlorë	Donika Hitaj	2,227,431				
62	Berat	Muharrem Asim Lybesha					

Të gjithë ata studentë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që iu ka skaduar viza duhet të dinë se nuk është e nevojshme të rikthehen sërish në Shqipëri për ta rinovuar. Kjo është deklarata e bërë ditën e djeshme nga ekspertët e ambasadës amerikane në kryeqytet. "Mbajtës të vizave studentore, nuk është e nevojshme të bëni gjithë atë udhëtim për në Shqipëri gjatë



## Hapat kryesore për të studiuar në SHBA

### Ambasada amerikane: Çfarë duhet të bëni nëse skadon viza studentore

pushimeve verore vetëm për të rinovuar vizën tuaj. Për sa kohë që frekuentoni rregullisht universitetin, ju mund të qëndroni në Shtetet e Bashkuara edhe nëse viza ju ka skaduar. Gjithsesi, nëse largoheni nga Shqipëria dhe viza

juaj është duke skaduar, sigurohuni që të caktoni një takim për ta rinovuar vizën. Planifikoni në kohë! - thekson ambasada. Çdo vit një numër i konsiderueshëm maturantësh dhe studentësh nga Shqipëria kërkojnë të nd-

jekin studimet bachelor dhe master në USA. Në këto universitete mund të aplikojë çdo i interesuar që përmbush kriteret e pranimit të vendosura nga vetë institucioni i arsimimit të lartë ku do të vazhdojë studimet. Secili univer-

sitet apo kolegji vendos vetë kriteret e pranimit dhe afatet e aplikimit. Prandaj hapi i parë është përzgjedhja e universitetit për të ditur çdo informacion në lidhje me këtë të fundit. Pas kësaj, aplikantët duhet të financojnë studimet duke aplikuar për bursë e më tej duke aplikuar për vizë studentit. Pas plotësimit të hapave të pikave të mësipërme, studentët duhet të përgatisin udhëtimin për në USA.

AKU: Bizneset të tregojnë kujdes. Produktet të jenë me etiketë dhe dokument fiskal

# Bllokohen 27 tonë miell gruri në Kakavijë

*Nuk garantohej siguria dhe cilësia e produktit*

Voltiza Duro

Po vazhdojnë kontrollet intensive për bizneset dhe mallrat që cenojnë sigurinë ushqimore për konsumatorët. Ditën e djeshme është bllokuar një ngarkesë prej 27 tonë miell gruri me origjinë greke nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Arsyja e bllokimit ishte mungesa e dokumentit që konfirmonte sigurinë e produktit. Fleta e analizës jo vetëm që nuk binte në përputhje me të dhënat e stampuara në thasët e miellit të grurit, por edhe nuk vërtetohej se kjo fletë analize ishte e thasëve të miellit të grurit dhe aq më pak të garantohej cilësia dhe siguria e produktit në fjalë. Fleta e analizës e paraqitur nga subjekti nuk korrespondonte me të dhënat e stampuara në thasët e miellit të grurit. Për më tepër, subjekti nuk dispononte në gjuhën shqipe certifikatat e sigurisë ushqimore bazuar në legjislacionin në fuqi. Subjekti i parregullt u konstatua nga trupa inspektuese e Drejtoriasë



Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, gjatë kontrollit të ushtruar në pikën doganore Kakavijë. Menjëherë pas kësaj AKU, bazuar dhe në legjislacionin

në fuqi, bëri bllokimin e ngarkesës si edhe kthimin e saj në origjinë. Gjithashtu, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit u bën thirrje edhe operatorëve të biznesit ushqimor



që të jenë të kujdesshëm në blerjen e lëndëve të para (shtazore apo joshnazore) dhe duke marrë nga furnitorët produkte me etikë shoqëru-

ar me dokumentin fiskal dhe veterinar. Kjo bëhet për qëllim të garantimit të sigurisë ushqimore për të gjithë konsumatorët në stinën e verës.

#### KONTROLLI

Ditën e djeshme është bllokuar një ngarkesë prej 27 tonë miell gruri me origjinë greke nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Arsyja e bllokimit ishte mungesa e dokumentit që konfirmonte sigurinë e produktit. Fleta e analizës jo vetëm që nuk binte në përputhje me të dhënat e stampuara në thasët e miellit të grurit, por edhe nuk vërtetohej se kjo fletë analize ishte e thasëve të miellit të grurit dhe aq më pak të garantohej cilësia dhe siguria e produktit në fjalë.

## "Punësim në industrinë e turizmit"

### Ministrat Klosi dhe Bushati, në panairin e Velipojës



#### APELI

Ministri Klosi apelojti të gjithë përpunuesit e produkteve shqiptare të shfrytëzojnë lehtësirat fiskale të ligjit të zejtarisë dhe atij për agroturizmin, për të rritur ekonominë e tyre familjare.

vendës dhe të huaj që kanë zgjedhur këtë verë Velipojën si destinacionin e tyre. Ministri Klosi apelojti të gjithë përpunuesit e produkteve shqiptare të shfrytëzojnë lehtësirat fiskale të ligjit të zejtarisë dhe atij për agroturizmin, për të rritur ekonominë e tyre familjare. "Zona e Velipojës, zona e Shëngjinit, e gjithë zona në të cilën me po zhvillojmë këto aktivitete ka shumë për të promovuar. Shikoj që për turistët e huaj kjo është një surprizë dhe mendoj që do të vazhdojmë me këto aktivitete gjatë gjithë zonës turistike të Shkodrës, duke vazhduar me Festën e Krabit në Shirokë e më pastaj për të shkuar në Panairin e Kullinarisë, që do të zhvillohet në shëtitoren e qytetit të Shkodrës", - tha ministri Klosi.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit u bën thirrje edhe operatorëve të biznesit ushqimor që të jenë të kujdesshëm në blerjen e lëndëve të para (shtazore apo joshnazore) dhe duke marrë nga furnitorët produkte me etikë shoqëruar me dokumentin fiskal dhe veterinar.

Artizanati, prodhimet e kullinarisë dhe prodhimet e traditës janë mundësi e gjerë e punësimit dhe rritjes së të ardhurave brenda industrisë së turizmit. Ministrat Blendit Klosi dhe Ditmir Bushati e vunë theksin tek këto mundësi për t'u shfrytëzuar në rritje të mirëqenies dhe ekonomisë në zonat me traditë dhe prodhime tipike vendëse. Në panairin e artizanatit, të zhvilluar në shëtitoren e re të Velipojës, në kuadër të organizimit të festave lokale të kësaj vere, dy ministrat vizituan stendat e paraqitjes dhe tregtimit të produkteve të zonës. Punimet me motive popullore, verërat në të njohura të zonës, gatimet dhe produktet bio u shijuan nga mijëra pushues

SI T'JU ZGJASË NGJYRA E NXIRJES?

# SUMMER


pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premte 10 Gusht 2018




Sherr në koncertin e Elvana Gjatës,  
publikohet videoja që po bën namin




Alesia Bami harron  
të depilohet

**BULEVARDI**  
POLITIK



- Meta ka një mesazh nga 2200 metra lartësi: Optimist për të arritur maja më të larta
- Niko Peleshi shkon në Festën e Birrës me vajzën modele
- Manjani: Popullit po i bien dhëmbët, qeveria 'mpreh të vetat'
- Në dasmë me këpucë të grisura, Princ Harry shfaqet siç nuk e keni parë kurrë



Rrëfahet bateristi: Ja emocionet që më dha Eurovizioni, fryma jonë në grup

## GERTI HIMAJ:

### Tregu muzikor po shtrembërohet nga ngjyrat e pakta

*"Bateria është çelësi i energjisë që buron nga shpirti"*

**Rrëfëhet bateristi: Ja emocionet që më dha Eurovizioni, fryma jonë në grup**

# Gerti Himaj:

## Tregu muzikor po shtrembërohet nga ngjyrat e pakta

*"Bateria është çelësi i energjisë që buron nga shpirti"*

Egla Xhemali

**E**ksperiencia në Eurovizion ka qenë një nga më të bukurat për të. Ai bashkë me bandën e ndezën skenën. Performanca e Shqipërisë në festival do të mbahet mend gjatë nga teleshikuesit. Gerti Himaj një nga bateristët më të dashur e më të talentuar që ka tregu në Shqipëri vjen në një rrëfim për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" për të na zbuluar zgjedhjen që ka bërë për t'i rënë baterisë, frymës që ka grupi, domethënies që kanë tatuazhet e shumta që ka në trup, dinamizmit si dhe planet që së shpejti do t'i realizojë. Bateria sipas tij është instrumenti që mban muzikën, po dhe një pasion i madh që e ka shpëruar gjithmonë. I shkon mjaft përshtat natyrës së tij energjike. Për publikun ata janë ndër bandat më të dashura. Gerti si një nga anëtarët më të rëndësishëm të bandës së Eugent Bushpëpës, pohan se ata janë në harmoni si kolegë dhe si miq. Ai ka shumë tatuazhe, të cilat nuk nguron të na thotë se kanë një domethënie

të veçantë. Për një baterist jeta është tejet dinamike duke përfshirë faktin se i duhet të udhëtojë gjithë kohën dhe të jetë prezent thuajse çdo natë në performancat live. Sipas tij tregu muzikor po shtrembërohet si pasojë e ngjyrave të pakta që u ofrohen njerëzve. Së fundmi, Himaj na tregon se ka dëshirë të vazhdojë studimet për instrumentin e baterinë jashtë.

**Si ka qenë eksperiencia në Eurovizion? Çfarë ndjesie ishte të ishe pjesë e asaj skene?**

Eksperiencia në Eurovizion ishte një ndër më të bukurat që kam pasur deri më tani. Ishte një ndjesi e papërshkrueshme kur pashë atë publik të madh para meje dhe mbi të gjitha emocion që përfaqësoja vendin tim. Kjo bën që të rritet me shumë përgjegjësia.

**Pse ke zgjedhur pikërisht baterinë?**

Përpara kam provuar shumë instrumente, po bateria më ngjiti më shumë dhe është instrumenti që mban peshën e muzikës. Duke i rënë përveç kënaqësisë heq dhe çdo stres që mund të kaloj gjatë ditës.

**Praktikon ndonjë instrument tjetër?**

I bie pak kitarës. Më pëlqen



ale ashtu edhe nga ajo monetare.(qesh)

**Cilin do e veçoje si momentin kur je ndërjerë më në vështirësi?**

Nuk di kë të veçoj, pasi kam pasur shumë vështirësi, por me shumë punë kam arritur këtu ku jam dhe mendoj që kam nisur një rrugëtim të mirë. E di që do kem prap momente të vështira se e tillë është jeta, por gjithmonë me punë dhe pozitivitet do t'ia dal.

**Cilat janë planet e Gertit për të ardhmen?**

Plani më i rëndësishëm për mua është të vazhdoj studimet jashtë Shqipërisë për instrumentin e baterisë, pasi në Shqipëri akoma nuk ka një të tillë. Dëshira ime është të rritem akoma më shumë profesionalisht dhe kjo arrihet me punë dhe me studim.

shumë kitara bass, sepse është e lidhur ngushtë me baterinë.

**Si është fryma brenda bandës suaj?**

Fryma brenda grupit është shumë harmonike. Në radhë të parë jemi shok, por edhe kolegë që punojmë me shumë profesionalizëm.

**Ti ke shumë tatuazhe në trup. Çfarë domethënie kanë ato?**

Jo të gjitha tatuazhet kanë një domethënie, por një pjesë e madhe kanë shumë domethënie për mua.

**Je natyrë mjaft solare. Gjithkund del i qeshur. Nga buron gjithë kjo energji?**

Kam qenë që i vogël mjaft i qeshur dhe solar. Vazhdoj të jem dhe tani, pasi kam fatin të ushtroj profesionin që dua dhe e bëj me shumë dëshirë. Këtë energji pozitive që kam dua t'ia përcjell dhe publikut dhe mendoj që nuk do më shterojë asnjë herë.


**Ka pasur ndonjë natë që je lidhur me baterinë e ke thënë nuk do i bie më?**

Ufff shumë herë, por nuk është nga lodhja më shumë sesa nga publiku. Në Shqipëri dhe jo vetëm muzika po shtrembërohet. Nuk po bëhet më ajo muzikë që ka mbijetuar deri më sot. Atë publik që kemi është shumë i zjarrtë. Më mirë pak e saktë.(qesh)

**Sa dinamike është jeta e një bateristi?**

Pafund. Duke qenë se është sezoni i verës netët live janë shumë të shpeshta dhe pothuajse çdo ditë jam në ndonjë vend të Shqipërisë ose jashtë saj. Është goxha e lodhshme, por dhe më jep kënaqësi si nga ana profesio-

dimet jashtë Shqipërisë për instrumentin e baterisë, pasi në Shqipëri akoma nuk ka një të tillë. Dëshira ime është të rritem akoma më shumë profesionalisht dhe kjo arrihet me punë dhe me studim.



## Sherr në koncertin e Elvana Gjatës, publikohet videoja që po bën namin

Ajo duket se nuk do të ndalet këtë verë. Përveç këngëve, klipeve apo bashkëpunimeve të sjella deri tani, Elvana ka dhe një axhendë të tejmbushur me koncerte në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Një pjesë të mirë të koncerteve po i mban në Kosovë. Së fundmi, bukuroshja ishte në Pejë. Gjatë koncertit ka ndodhur një sherr, që është bërë publik me një video. Në video dallohen rojet e sigurisë të klubit, të cilët qëllojnë në grushte një prej fansave të pranishëm. Nuk dihet saktësisht se çfarë ka bërë fansi ndaj të cilit është reaguar në këtë mënyrë të dhunshme, por videoja e shpërndarë nga përdoruesit e rrjeteve sociale ka marrë komente të shumta.




## Brenda vilës luksoze të Zaimina Vasjarit, do ju shohin sytë mrekulli

Zaimina Vasjari është një nga femrat shqiptare, që më së shumti është lakuar për jetën e saj luksoze dhe udhëtimet në vendet më të shtrenjta. Tashmë ajo është në krye të listës, si nëna e re me format trupore më seksi. Zaimina dhe vajza e saj Khloe ndajnë shumë kohë së bashku.




Bukuroshja ka qenë ,mjaf aktive në rrjetin social "Instagram". Në postimet e saj të fundit Vasjari ka treguar një pjesë të vilës së saj. Dy vajzat bukuroshe të shtëpisë kanë zgjedhur të relaksohen më pishinën e vilës së tyre.



## 'Gota ka, po s'ka profesionistë', Xhemi e djeg me pije

Moderatorja Xhemi Shehu është duke e shijuar në maksimum këtë verë. Ajo shpesh ndan në "Instagram", momente me miqtë e 'Portokalli' nga udhëtimet e tyre nga edicioni veror, që po organizohet në qytetet e vendit. Në një nga postimet e fundit të saj, Xhemi duket e buzëqeshur para disa gotave me pije. 'Gota ka, po s'ka profesionistë', ka shkruar Xhemi në foton e saj ku si gjithmonë shfaqet e qeshur.



## Alesia Bami harron të depilohet

Balerina e emisionit "Stop" dhe njëkohësisht modelja super seksi Alesia Bami është një nga vajzat më të komentuar të show bizit shqiptar. Bukuroshja ka qenë mjaf aktive në rrjetet sociale duke ndarë me të gjithë fansat foto tejet provokuese me bikini. Duket se kjo verë për të nuk ka të mbaruar. Së fundmi, Alesia ka postuar një foto në "Instagram", që mesa duket ka qenë e pavëmendshme. Modelja ka harruar të depilohet dhe qimet janë të dukshme.





**P**ër shumëkënd vera mund të jetë stina më e 'urryer' e vitit sidomos nëse ju duhet të punoni ndërkohë që të tjerët pushojnë, të ecni në këmbë në pikun e diellit, të mos keni kondicioner ose ventilator në shtëpi etj. Urojmë që personat e mësipërm të jenë sa më të paktë në numër pasi vera është sinonim i detit dhe diellit, pra i kënaqësisë. Nëse keni pak orë që keni nisur pushimet, lexoni këshillat e mëposhtme nëse doni që të keni një nxirje perfekte këtë verë.

**Pini sa më shumë ujë dhe lëngje të freskëta**

Një ndër këshillat më të shpeshta që do të dëgjoni gjatë verës është të pini sa më shumë ujë dhe lëngje të freskëta. Hidratimi i vazhdueshëm jo vetëm ju ndihmon të ruani ekuilibrin e lagështisë së trupit, por edhe ndihmon që të merrni rrezet në mënyrë të njëtrajtshme. Këshillojmë që të mos ndani nga tryeza edhe ushqimet e mëposhtme si: trangulli, sallata jeshile, selinoja, luleshtrydhet, pjeprri dhe shalqiri.

Ushqimi luan, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në ruajtjen për një kohë sa më të gjatë të ngjyrës çokollate. Sigurisht që mbretërit e tryezës janë produktet e detit, por janë të tjera ushqime ato që ju ndihmojnë të keni një nxirje perfekte këtë verë.

Po flasim për ushqime të pasura me vitamina A, C dhe E, si dhe me beta-karoten, një antioksidant shumë i rëndësishëm që ndihmon trupin të përthithë sa më mirë rrezet e diellit.

Mos u mendoni më gjatë, por filloni që të hani që tani: karota, domate, kajsi, pjepr, portokaj, sallatë jeshile, spinaq etj.

**Bëni dy-tre herë në javë scrub**

Mënyra më e mirë për të patur një nxirje perfekte dhe të njëtrajtshme që zgjat në kohë është duke eliminuar paraprakisht qelizat e vdeku-



# Si t'ju zgjasë ngjyra e nxirjes?



ra nga lëkura. Për këtë arsye ju vjen në ndihmë scrubi - në një enë shtoni vaj ulliri, sheqer, kafe dhe lëng limoni. Pasi të përzieni të gjithë përbërësit bashkë, masazhoni lëkuren të lagur paraprakisht, me scrubin e mësipërm.

**Mos u ekspozoni gjatë orëve të nxehta të ditës**

'Sa më shumë të qëndrojnë në diell, aq më shumë do të

nxihem'. Kjo s'është aspak e vërtetë pasi jo vetëm që nuk do të keni rezultatin e dëshiruar që në këtë rast është nga e nxira në të kuqe, por rrisni mundësinë për të patur njolla kafe, akne dhe djegie të shkallës së parë e të dytë. Këshillohet që të shmangni ekspozimin në diell nga ora 12:00-16:00.

**Përdorni krem dielli dhe jo vajra natyralë**

Në qoftë se keni kohë që nuk bëni pushime me familje, me siguri e keni humbur 'gjenialitetin' e të gjitha nënave shqiptare : vaji i ullirit. Nuk ka rëndësi nëse e mbajnë në shishen e një vaji lëkure që nuk përdorni më, apo e kanë marrë direkt nga shtëpia në shishe plastike, vaji i ullirit nuk duhet të mungojë nën çadër. Megjithatë duhet të dini që ai jo vetëm që nuk ndihmon

nxirjen, por nëse e përdorni që në daljet e para në dielli mund të rrezikoni të digjeni. Zgjidhni një krem dielli me faktorë SPF mbi 30 dhe lyhuni vazhdimisht me të gjatë diteve të para. **Ndryshoni vazhdimisht pozicionin** Në qoftë se bëni pjesën në kategorinë e njerëzve që nuk ndryshojnë vend gjatë tërë kohës që ekspozohen në diell, nuk e keni punën mirë.



## Meta ka një mesazh nga 2200 metra lartësi: Optimist për të arritur maja më të larta

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u ka bërë publicitetin më të mirë të mundshëm bukurive të natyrës së Kosovës nga bjeshkët e Rugovës deri tek ato të Prevallës. Ndonëse është kreu i shtetit shqiptar, duket se Meta ndihet optimist për të arritur maja edhe më të larta, siç thotë ai në një mesazh 30 sekonda të postuar në profilin e tij zyrtar në "Facebook" ku ndodhet në mbi 2200 metra lartësi. "Të dashur miq, ju përhëndes këtu nga maja e Oshlakut, 2217 metra mbi nivelin e deti në bjeshkët përralore të Prevallës. Ndaj do doja t'ju ftoja të gjithëve t'i vizitoni këto bjeshkë të jashtëzakonshme, mjaft oskigjenuese, mjaft frymëzuese, mjaft të shëndetshme dhe njëkohësisht që të bëjnë më optimist për të arritur maja më të larta", shprehet Meta nga bjeshkët e Prevallës.



## Niko Peleshi shkon në Festën e Birrës me vajzën modele

Eventi më i madh festiv në Shqipëri, Festa e Birrës ka star tuar në Korçë. Me qindra qytetarë janë ndisur drejt qytetit juglindor për t'u bërë pjesë e traditës korçare, po jo vetëm qytetarë. Mes të pranishmëve të shumtë, në festën e mbrëmshme ishte edhe ministri i Bujqësisë Niko Peleshi, i shoqëruar nga familja e tij. Peleshi ka publikuar foto nga festa, ku duket dhe vajza e tij Aleksia, me profesion modele. Në fakt, Alesia nuk është aspak e panjohur për publikun, pasi jo pak herë është bërë kryeteme e mediave rozë. Ndërsa Korça do jetë "flakë" në 5 netë e organizimit të saj, nga dita e djeshme deri në 12 gusht.



# BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

## POLITIK



## Manjani: Popullit po i bien dhëmbët, qeveria 'mpreh të vetat'

Pas një sondazhi të Komisionit European ku rezultoi se 77% e shqiptarëve e kanë të vështirë që të përballojnë shpenzimet dentare, vjen një reagim nga ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani. Ky i fundit përmes një statusi në "Facebook" ironizon qeverinë, ndërsa shkruan se kjo e fundit i ka 'mprehur dhëmbët e veta': "Komisioni European ka gjetur se 77% e Shqiptarëve nuk përballojnë dot dentistin.

Konkluzion: Popullit po i bien dhëmbët, ndërkohë që qeveria vetëm i mpreh të vetat!", shkruan Manjani. Në këtë sondazh, Shqipëria renditet e para në Europë që nuk përballon dot këto shpenzime dhe pas saj Greqia, ku 68% e të anketuarve kanë thënë se e gjejnë të vështirë apo shumë të vështirë që të përballojnë përkujdesjen dentare në vend.



## Në dasmë me këpucë të grisura, Princ Harry shfaqet siç nuk e keni parë kurrë

Ish-deputetja e LDK-së, Melihate Tërmkolli, iu kundërpërgjigj Rexhep Qosjes, i cili mbështeti idenë e shkëmbimit të territoreve. "Akademiku, me këtë logjikë, na thotë se edhe Lugina edhe Veriu qenkan të Serbisë, prandaj hajt ta mashtrujmë pak Serbinë e ia marrim bile Luginën. Po pra! Rrjedhimisht akademiku Qosja na thotë se Serbia paska pasur të drejtë që ka bërë gjenocid kundër shqiptarëve, se lufta e saj kundër shqiptarëve e Kosovës paska qenë legjitime siç na qenka legjitime e drejta për Veriu e Kosovës", shkruan Tërmkolli. "Mjeshtri i regjur në sallonet e Beogradit, prandaj provon të na akuzojë

se nëse nuk e pranojmë idenë e tij dhe dishepullit të tij atëherë del se 'kundërshtarët e shkëmbimit të territorit, po ia dhurojnë Serbisë edhe Luginën edhe Veriun' dhe si 'baba' i mirë, ai do të dëshmojë nesër para historisë dhe të na thotë troç, se ja pra 'nuk deshët ta jepni veriun, e humbët edhe Luginën edhe Veriun', shprehet Tërmkolli.



## KASTRIOTET

Nga Ylli Polovina

# GJON KASTRIOTI

## Luftë kundër osmanëve, dashuriçka në Napoli e sjellje e pahijshme me të ëmën Donikën

*Një portret i djalit të vetëm të Skënderbeut dhe të dhënat për jetën përballë detit*

Reth 23 majit 1468 bashkëshortja e Skënderbeut, tashmë katër muaj më parë, në 17 janar, jetë ndërriu: Donika, regjente e principatës Kastrioti, e kaloi detin me një anije të posaçme të dërguar prej aleatit të parë të tyre strategjik, mbretit të Napolit, spanjollit Ferdinand (i Aragonës).

Po ikte bashkë me trashëgimtarin e pushtetit dhe të pronave të princit Gjergj, të birin e vetëm, Gjonin. Ky ishte sapa duke kapërcyer të trembëdhjetat. Po mërgonin jo përfundimisht, por për t'u rikthyer sa më parë. Në anijen e posaçme për ta ndodheshin edhe disa të veja komandantësh të rëndësishëm të ushtrisë arbëre.

Zhvillimet që ndodhën pas mërgimit të përkohshëm të familjes së Gjergj Kastriotit ishin të tilla që brenda një dekade pothuaj e shuan mundësinë e rikthimit të tyre. Megjithatë vetë Gjoni dhe të paktën dy nipër të tij dëshmohe se në krye të komandove të ndryshme të financuara e pajisura nga Republika e Venedikut apo Mbretëria e Napolit kanë rihyryrë në Shqipëri për akte diversioni, kapje plasdarmesh apo edhe aksione të gjëra çlirim, ajo ikje e pranverës 1468 kishte qenë pa rikthim.

Një dekadë më pas nëpërmjet një superoperacioni gjigand, komanduar nga dy gjeneralë turq dhe për dy-tri muaj edhe në krye me vetë sultanin Mehmet II, të famshmin "Pushtues i Botës", armata osmane pushtoi pas një qëndrese heroike kështjellën e Krujës, të Zhabjakut, të Drishtit, të Lezhës dhe motin e ardhshëm edhe vetë Shkodrën.

Këtë zhvillim të ngjarjeve as regjentja Donikë dhe ca më pak shumë i riu Gjon, atë 23 maj nuk e përfytyronin dot. Po ashtu me sytë nga rikthimi në Arbëri ata qenë edhe kur zbarkuan e ndoqën jetën në Itali. Kështu familja princërore Kastrioti e vijoi kronikën e saj larg trojeve të shqiptarëve dhe për fat të trishtë edhe larg lidhjeve e vëmendjes reciproke të dy palëve, duke krijuar kështu një nga gropat më të mëdha të kujtesës sonë kombëtare.

Ky shkrim është një përpjekje modeste për të shkëputur diçka prej këtij terri.

### "TRI PRINCESHAT E TRISHTUAR"


Princeshës Donikë dhe të birit mbreti Ferdinand (Ferrante) i lidhi një pension të përvitshëm prej një mijë dukatësh të arta. Si provë të kësaj përkujdesjeje për bashkëshorten e Skënderbeut ka ekzistuar edhe një dokument, tashmë fizikisht, si origjinal, i humbur.

Atje emri i saj shkruhet në formën Donike Areniti.

Pas afro dy muajsh nga zbarkimi, qysh nga 27 gushti 1469, e veja e Skënderbeut u transferua në shtëpitë e të njohurit Pietro Kola d'Alessandro (Pietro Cola d'Alessandro), në afërsi të Santa Kiarës (Santa Chiara). Disa vite



Në foto:  
Donika Kastrioti



më pas, në shtator 1477, kur në Napoli erdhi Xhovana III (Giovana III), nusja e re e mbretit Ferdinand, u lidh një marrëveshje midis Donikës dhe saj. Ajo do të rrinte pranë dy mbretërëshave, të cilat më pas do të quheshin "Dy Xhovanat e trishtuara".

E para e tyre do të qe vetë bashkëshortja e Ferdinandit. Kur ky vdiq në 25 janar 1494, ajo mbi çdo dekret filloi të firmoste me bashkëngjitur shprehjen "Mbretëresha e trishtuar". Ndërkaq në 20 prill 1479 çifti pati lindur vajzën e vetme të tyre, të cilës i vunë

emrin Xhovana. E shpallur mbretëreshë kur qe shtatëmbëdhjetë vjeçe dhe e martuar me kushëririn, Ferranten, pas disa muajve martesë të kryer në 1496, ky vdiq para kohe prej malaries (infeksion të marrë gjatë gjahut) apo, siç edhe përfillet, nga një helmim. Pas kësaj edhe Xhovana e re firmoste njëllëj si e ëma.

Prej vitit 1477, kur nis ngjitja e saj, e deri sa në fillim të shekullit pasardhës ndërroi jetë, Donika përfaqëson në Napoli një figurë me autoritet. Përgark saj u mblodh një rreth jo i vogël arbrish, që nga

Aranitët dhe Muzakët, por sidomos pasardhës të fisnikut krutan Vrana Konti.

Këta u bënë jo vetëm mbështetës të këtij prestigj politik të së vesë së Skënderbeut, por edhe për shumë dekada me radhë njëri prej pinjollëve vranakontë, Bernardo, lehtësuar nga kjo lidhje, u bë edhe më i pasuri, pas monarkut, i të gjithë mbretërisë së Napolit.

Është një kulmim i autoritetit të shqiptarëve hapësira gjysmëshekullore e viteve sa qe gjallë Donika, madje vijoi edhe për tre-katër dhjetëvjeçarë të tjerë më pas. Në 1508 apo 1510, kur mendohet që është shkruar dhe publikuar libri i Marin Barletit për Skënderbeun, ishte kulmi i prestigjit të këtij lobi arbëreshësh në Napoli, edhe pse tashmë, në ditët mes marsit 1505 dhe shtatorit 1506, stërgjyshja e tyre nuk jetonte më.

Siç e tregon edhe skënderologu i njohur italian, Prof. Xhankarlo Valone (Giancarlo Vallone), Donika banonte në katin e dytë të Castel Nuovo (Kështjellës së Re), rezidencës mbretërore, dhe bashkë me formën e shqiptuar Andronaka në këto mjedise ajo thirrej më së shumti "Scannalibeca". Duket është ruajtur mënyra arbëre e emërimit të një bashkëshorteje,

e përhapur fort edhe në Dibër, ku emrit të bashkëshortit, tek gruaja e tij, gjuhësisht femërizohet. Me një fjalë Donika ishte ndryshe edhe Skënderbegia.

Në 18 gusht 1489, ka një dokument tjetër të shfaqjes së emrit të saj. Bëhet fjalë për një urdhr të monarkut Ferrante, në të cilin "Andronika Areniti" merr pranë vetes, për t'i shërbyer, një djalë arbër me emrin Kola.

Në dokumente ajo duket sërisht në 20 tetor 1494, kur nipi i Alfonsit V, edhe ky mbret me emrin e gjyshit, i beson Donikës kujdesin për dy Xhovanat e mbetura. Këtë cast, thekson Xhankarlo Valone, ka fjalë shumë të bukura të tij për shpirtin e mirë të saj.

Kur në vitin 1496 u rindërtua në Castel Nuovo apartamenti i mbretëreshës së re Xhovana, "zonja Andronika" kishte një dhomë mbi të. Ajo ndodhej në katin e dytë të krahut përdimor.

Mbreti Ferrandino, siç thirrej nipi i Alfonsit V, i cili vdiq në moshë të re, në 7 tetor 1496, shkaktoi në Castel Nuovo dëshpërimin e madh të bashkëshortes së tij Xhovana dhe dëshirë të saj për ta braktisur menjëherë Napoli. Megjithatë qe kryekujdestarja e saj, Donika Kastrioti, ajo që e bindi të mos vepronte ashtu.


Në 13 shkurt 1498 Donika gjendet në një dokument tjetër, i cili dëshmon përqafimin e sinqertë të mbretit të ri, Federikis, me "la moglie de Scannalibecho" ("gruaja e Skënderbeut"). Sipas studiuesit Valone, qe pikërisht ky monark, i cili më 1 prill 1498 i dha një feud më vete, tokën e Galianos, brenda Kepit të Leukës.

Kjo u bë që të mund të jetonte e pavarur, e çliruar prej varësisë së të birit, i cili ndodhej në Pulie, në Galatina, dhe kishte dhënë shenja se mbante me të marrëdhënie të ftohta.

Në 7 shtator 1499 dëshmohe se ajo ende ndodhej në Napoli dhe nuk dëshiron të shkojë në Spanjë me Xhovanën e vogël, por do t'i vejë pas më vonë, atje, Xhovanës tjetër, për ta shoqëruar.

Studiuesi arbëresh, profesor në Universitetin e Kozencës, Atilio Vakaro, në konferencën ndërkombëtare për Skënderbeun, të organizuar në Universitetin Oriental të Napolit në 1-2 dhjetor 2005, do të thoshte se Karlo Padillone, do të thoshte të metat e tij, në librin e vet paraqet një dokument origjinal, ku provohet se në 1500 Donika ndodhej në Napoli.

Është viti kur ajo kryen gjestin



Në foto: Gjergj Kastrioti

që do të mbetet i fiksuar njëherë e përgjithmonë në këtë qytet: një varr-monument për nipin e saj Constandinus de Scanderbechis, i cili kishte qenë peshkop i qytetit të Izernias dhe vdiq në moshë fare të re, atë vit 1500.

Në tekstin e gjatë përkushtues, të gdhendur në mermer, dallohen qartë fjalët "Constandinus Castrayotus" si edhe vetë emri i saj "Andronica Cominata".

Ndërkaq një dokument i legatës veneciane në Napoli e regjistron qartë Donikën në janar 1501: "la moglie fo dil sinor Scandarbecho" ("grauja e zotit Skënderbeu").

**I HUMBËN ESHTRAT NË SPANJË**

Sipas Prof. Valones, grupi shoqërues i mbretëreshës Xhovana do të nisej nga Napoli për në Sicili më 2 dhe 3 gusht 1501 dhe në Spanjë do të arrinte vetëm në korrik 1502. Në 8 mars 1505 është dokumenti i fundit i Donikës gjallë. Ajo i shkroi nga Spanja një letër mjaft prekëse nipit të saj Ferrante, i cili kishte toleruar në Galatina, feudin e tij, sjelljen arrogante të një reparti ushtaraksh spanjollë që ishin në ndjekje të një opozitari të mbretit.

Këta, për pesëmbëdhjetë ditë, e patën plaçkitur qytetin. Donika i shkroi të nipit edhe një letër tjetër. E pati qortuar pse në një rast të dytë banorët galatinas, të futur në Mitropoli para rezidencës së tij kështjellorë, patjetër në një protestë, i kishte qëlluar me top. Nga çfarë del prej dokumenteve të pakta të kohës, në këtë veprim të rëndë Gjonin e pati shtyrë e shoqja, Erina.

(Gjon Kastrioti që martuar në vitet 1475 apo 1476, e shumta tetë vite pas emigrimit, në moshën njëzetë e apo njëzetë e një vjeç, me Jerina Brankoviç, vajzën e princit serb Lllazar. Edhe këta, për shkak të pushtimit osman, qenë të emigruar në Itali. Siç dihet vetë Jerina (Erina italish) ishte bijë e lidhjes martesore të Lllazarit e Helena Paleologun, pjesëtare e familjes perandorake të Bizantit).

Aq të acaruaru përfunduan marrëdhëniet e Ferrantes, nipit të Skënderbeut, me vendasit sa ky u detyrua ta braktiste Galatinën dhe të fshihej në Soletto. Iu desh nënës së tij fjalëbutë që t'u shkruante një letër ndjese banorëve të feudit dhe kështu të mund të riparohej kjo marrëdhënie arrogante e të biriti.

Kur në ditë e para të shtatorit 1506 dy Xhovanat u kthyen sërish në Napoli, Donika nuk jetonte më. Varr i saj nuk gjendet.

Sipas njëres prej Xhovanave, të madhes, strehë e fundit e bash-

këshortes së Skënderbeut ka qenë nëntoka e Kishës së Trinisë së Shenjtë në Valencia. Madje në testamentin e saj ajo urdhëron zhvendosjen e eshtrave të Donikës për në Napoli. Kaktos edhe vendin e prehjes: një kishëz në varësi të kishës së madhe Santa Maria dela Konçencione (Santa Maria della Conçenzione).

Por kjo gjë nuk u krye, sepse hyri në mes një grindje mes vranakontëve, që tashmë administronin prestigjin e Donikës me një person plot pushtet në oborin mbretëror napolitan.

Kështu varri i saj mbeti në Spanjë. I humbur

**JO MIRËNJOHËS ME TË EMËN**

Donika jetoi më gjatë se i shoqi, 78 vjet. Skënderbeu pati shkruar deri në moshën 63 vjeçare. Në qiell, tek Zoti, ekzistencën e të cilit e besonte shumë, Donika shkoi pothuaj në të njëjtën kohë me të birin, Gjonin, çfarë ka qenë një dhimbje jo e vogël. Ajo grua e fortë e familjes Kastrioti pa vdekje tek të vetët më tepër nga sa duron një zemër njeriu.

I pari që nipi Kostandin, biri i dytë i Gjonit. Peshkopi i Izernias për vetëm dy vite e pak muaj, vuajti nga një sëmundje e rëndë.

Por Donika do të vuante edhe historinë e nipit më të madh, fëmijës së parë të Gjonit: Gjergji (Giorgio). Ai nuk mbante vetëm emrin e të shoqit, por edhe që trashëgimtari i drejt për drejtë i dinastisë së tyre. Në shkurt 1500, kur përafërsisht mund të ketë ngjarë vdekja e Kostandinit, Gjergji i ri që 23 vjeç e disa muaj.

Ishte ky që në 1501, duke filluar nga muaji shkurt, kreu ekspeditën fatkeqe për çlirim në Shqipëri dhe pas dështimit nuk u kthye më në shtëpinë prindërore. Lajmi i parë për të mbërriti në Napoli dhe në kështjellën dukale të Galatinës vetëm në 18 dhjetor 1505. Kishte ardhur nga Kostandinopoja. Thoshte as më shumë dhe as më pak: "Skënderbeu është bërë turk".

Donika nuk duhet ta ketë kaluar pa dhimbje marrëdhënien me djalin e saj të vetëm, Gjonin. Siç më sipër e vumë nën vëmendjen e lexuesit, sipas një dokumenti të 26 nëntorit 1499 është dyshuar për një mosinteresim të tij për të emën. Ndoshta ftoha ka qenë edhe më tepër se kaq. Sipas website-it të familjes Kastrioti në Itali, dega e Leçes, castriotascanderbeg.it, një vit e gjysmë më parë, në 1 prill 1498, mbreti i Napolit, Federiko, i dha gruas së Skënderbeut, që ajo të ishte ekonomikisht e vetëmjaftueshme, feudin Galiano del Kapo (Gagliano del Capo). Ndërkaq web-



Në foto: Emblema e Gjergj Kastriotit në Napoli të Italisë

**CASTRIOTA-SCANDERBECH DI NAPOLI**

site i kësaj komune italiane shkruan se kjo gjë ka ndodhur jo në 1498, por në vitin 1495. Sipas këtij burimi informimi, "pasardhësit e familjes Castriota Scanderbegh jetonin në kështjellën e Gaglianos, të vendosur përballë kishës".

Një ballafaqim i këtyre të dhënave lë shkas të besohet se historia e zotërimit të kësaj prone, si atëherë dhe sot një qytetë fare e vogël, ruan brenda vetes një konflikt të heshtur e të gjatë mes Gjonit dhe nënës së tij.

Kur komuna Galiano del Kapo, në faqen e saj të internetit, shkruan për pasardhës të Skënderbeut të vendosur në kështjellën para kishës, patjetër e ka fjalën jo për Donikën. Ajo nuk lëvizte prej atij qyteti, e ngarkuar, siç ju kemi informuar, me detyrën non stop të kujdesjes për dy mbretëreshat e trishtuara Xhovana. Ndërkaq kronikat e Napolit regjistrojnë të birin e saj, i cili sapo rritet pak, largohet nga e ëma dhe vendoset pranë pronave në anën tjetër të gadishullit, në bregdetin adriatiko-jonian.

Mbështetur mbi njohjen që profesor Valone i ka bërë kësaj teme, ndërsa në krye të Mbretërisë së Napolit që për pak kohë monarku francez Karl VIII (Carlo VIII), "Gjon Kastrioti kishte bërë një përpjekje të pahijshme për ta marrë feudin e Galianos".

Sapo mbreti francez iku dhe mbretëria u rikthye tek zotëruesit e vjetër, Aragonët, ndodhi akti i 1 prillit 1498, kur Federiko ia mori këtë pronë modeste Gjonit (që kishte dy të tjerë të mëdha) dhe ia dha nënës së tij.

Dokumentet e kohës, të ruajtura në Napoli dhe Pulie, dëshmojnë se, ndërsa Donika në çështje të ndryshme civile ndërhynte shpesh në favor të të birit, ky i fundit nuk vepronte aspak ashtu.

Zemërgjerësia e së emës nuk ishte kurrë tek i biri.

Valone e rrëfen jetën e Gjon Kastriotit si një person të ngarkuar nga Mbretëria për mbrojtjen e zonave të saj të jugut prej turqve. Ndërsa në qershor 1484 ai pati luftuar kundër venecianëve, në 7 shtator 1481 bëri zbarkim dhe diversion në Shqipëri, në brezin Vlorë-Himarë. Synoi thyerjen e darës turke në Otranto, e cila që e pushtuar prej osmanëve që në 28 korrik 1480. Dhe detyrës së tij luftarake ia doli. Otranto u çlirua tri ditë më vonë, në 10 shtator 1481. Ndërsa më pas kreu edhe sipërmarrje të vogla ushtarake, diversion zbarkimi në bregdetin shqiptar, po aq kanosës si në 1481, Gjon Kastrioti realizoi edhe në vitin 1488.

Për ta vizatuar sa më qartë të birin e vetëm të Skënderbeut Xhankarlo Valone shkruan: "Në Itali Gjoni nuk kishte luajtur kurrë role të dorës së parë dhe sidomos pas lidhjes me Erina Brankoviçin, një princeshë serbe, nuk kishte lidhje të ngushta as me klasën feudale të mbretërisë, e cila që armike e monarkut Ferdinand". Sipas tij, "Gjoni ishte mirënjohës dhe i devotshëm ndaj mbretit të Napolit...". Më pas: "Banorët e Salentos, kur iu dhanë pronat, nuk dëshën as ta prisnin, as ta njihnin, por ua imponoi Ferdinandit. Feudalët e terrenit nuk e donin mbretin dhe Gjoni hynte në njerëzit e tij".

Po ashtu Valone vijon: "Mënyra e të qenit ushtar përcaktonte mendësinë e tij për të jetuar në provincë si një feudal prepotent, po jo kryeqend, fillimisht në Pulien e sipërme dhe pastaj në atë të largët".

Profesor Valone njëkohësisht vë në dukje se "Gjon Kastrioti, që kur ishte pronar i feudit të San Giovanni Rotondo-s, kishte pritur në këtë vend një bërthamë të konsiderueshme prej 20 familjesh shqiptare".

Siç duket, i biri i vetëm i

Skënderbeut nuk është arbër shpirtkeq, ca më pak mohues i viseve dhe i mëmëdheut të vet. Megjithatë ngjan shumë i ndikueshëm nga e shoqja.

Xhankarlo Valone ngul këmbë se "Thjeshtësia e tejskajshme e sjelljes dhe e shpirtit të Andronikës nuk gjendet tek i biri mujshar. Veç arroganca e të parit që ves feudal më shumë se e metë e vetë Gjonit".

Sidoqoftë e trishtueshme mbetet jetëgjatësia e tij. Gjon Kastrioti jetoi shumë më pak se i ati, Skënderbeu. I mbylli sytë pesëdhjetë vjeç.

**PËRFOLJE TË NDEZURA PËR DASHURICË TË GJONIT**

Napoli, ky qytet gazmor dhe i mbushur me fjalëna, ka të shkruar në një nga faqet internetike më të ndjekura, ku rrefehet për historitë e secilës familje fisnike të tij, edhe thashetheme rozë për Gjonin.

Pasi thotë se ky djalos i ri erdhi prej Shqipërisë me të emën dhe që mik i Ferdinandit të Aragonës, pati si dhuratë prej mbretit kështjellën e Galianos në Tokën e Otrantos.

"Kur u rrit, shkruan website www.nobili-napoletani.it, princi i Shqipërisë, i konsideruar luan i aristokracisë napolitane, u bë dashnori i dy mbretëreshave "të trishtuara". Pasi "ngushëlloi" mbretëreshën Xhovana III, u magjeps nga huret e bijës së saj, mbretëreshës Xhovana IV, e veja e Ferrantinos (Ferrante II i Aragonës).

Për t'i mbajtur të fshehta marrëdhëniet e tyre, të dy të dashuruarit takoheshin në kështjellën Somma Vesuviana, rezidenca e veçuar e sovranes në rrëzë të malit të Vesuvit, larg nga e ëma që jetonte në Kastel Kapuano".

Por a mund të jetë e vërtetë e gjithë kjo histori rozë? Si edhe të tjerat?

Kastriotët janë meshkuj të fortë e të bukur, shtatlartë po ashtu. Mbase Gjoni ndaj femrave ka qenë edhe i ëmbël. Prania e Donikës në rrethin mbretëror të dy Xhovanave, si kryekujdestarja e tyre, mund t'i ketë krijuar pa dashje rrethanat lehtësuese për aventurat e të birit.

Veç nuk duhet të harrojmë se Gjoni kryesisht jetonte larg, në Pulien jugore, dhe i duhej shumë rrugë të vinte aq shpesh në Napoli sa të mbante të gjalla këto flirte.

Por legjenda (apo e vërteta) popullore për Gjonin si "Don Zhuan" i thekur gjallëron përherë në Napoli. Këtë vit autori i këtij shkrimi ka bërë dy takime me lexues në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, me të paraburgosur, në Vaqar të Tiranës dhe në të dy herët ka biseduar me një napolitan (Ciro) që priste dënimin për shpërndarje droge. Origjina e tij ishte prej familjeve të dikurshme të fuqishme spanjolle të qytetit dhe ai e njihje historinë e Skënderbeut (por edhe të Donikës e të Gjonit) më mirë se shumë shqiptarë. Çiro këmbëngulte për natyrën e shpenguar të raporteve dashurore me gratë të birit të vetëm të Gjergj Kastriotit.

Gjithsesi, që apo jo tip dashnor, kjo histori e trëndafilte dëshmon se Gjoni në Napoli kishte emër dhe bëmë. I ati e fitoi famën me sakrificat të mëdha spartane, me jetë lag qefjeve, por i biri jetoi një mënyrë tjetër protagonizmi si Kastriotas.

# Media dhe kufijtë e rinj të Kosovës. Analizë e konspiracion

Nga Eva Londo

(vijon nga faqja 1)

...e artikuluar edhe më parë, por e rivendosur fuqishëm në axhendën e diskutimeve në parapritje të nisjes së bisedimeve mes dy vendeve me ndërmjetësimin e BE. Kosova përbën një argument të shumë të elaborueshëm për diplomacinë ndërkombëtare dhe një lajm për mediat e botës. Vazhdimisht, ajo ka prezantuar interes politik e publik dhe ka gjeneruar lajm duke u bërë një kauzë e shumë njohur, por edhe kontraverse. Këto kohë, Presidenti Thaçi ka lançuar një argument të ri që ka shkaktuar diskutime mes faktorit ndërkombëtar dhe kazaptuar faqet dhe hapësirat e mediave ndërkombëtare. Qëndrimi i tij u cilësua si reagim ndaj idesë së hedhur prej qarqeve serbe për shkëmbim gjeografik tokash, bazuar mbi raportin mes popullsisë etnike serbe dhe minoritetit shqiptar atje, - shkëmbimin e rajonit verior të Kosovës, Mitrovicës, për Luginën serbe të Preshevës, - propozim që do të çonte në zgjidhjen e mundshme të çështjes së Kosovës. Ndërsa, qarqet serbe e kanë hedhur këtë propozim edhe më herët, ishte pikërisht reagimi dhe qëndrimi i Presidentit të Thaçi, që ktheu vëmendjen tek Kosova dhe e pozicionoi sërish atë në diskursin publik. E ndërkohë që diplomacia e media perëndimore është më pak reaktive kur nevojitet të pozicionohet në raport me marrëdhëniet me Serbinë, edhe si pasojë e mbështetjes që kjo e fundit ka prej Ruisë, Kosova, e cila është produkt i diplomacisë perëndimore prezanton më shumë sensibilitetet dhe rrjedhimisht gjeneron më shpejt reagim e mbullim mediatic. Në këtë diskutim që mediat shqiptare, kosovare dhe perëndimore ndërmorën u përfshinë ekspertë, politikanë, ambasadorë, studiues, të gjithë duke analizuar anët pozitive e negative të një veprimi të tillë të mundshëm. Por, a ishte kjo një qasje strategjike për të testuar dhe matur pulsionin e opinionit diplomatik e publik ndërkombëtar, apo një taktikë për të disenjuar argumente që do të ndihmojnë palët në fazën e negociatave që do të nisnin së shpejti? Kujt i shërben kjo taktikë?

Historia e re botërore i ka shumë të freskëta rastet kur Kosova është përdorur dhe vendosur me takt në axhendën diplomatike e publike duke gjeneruar lajm dhe reagim. Katër vite më parë, në 2014-ën, Kosova u risoll fuqishëm në axhendën e mediave dhe atë publike, kur presidenti rus, Vladimir Putin deklaroi se "Krimeja është Kosovë", argument të cilit u përdori për të shkëputur rajonin autonom të Krimesë prej Ukrainës dhe vendosur atë nën Rusinë. Kjo ngjalli një debat të fuqishëm diplomatik, i vendosur i gjithi në media, ku u analizua gjatë dhe në detaje legjitimiteti dhe arsyet që prodhuan shtetin e Kosovës dhe që rrjedhimisht, legjitimojnë çdo precedent të ardhshëm të mundshëm që mund të ndodhte. Krimeja për Putin ishte njësoj si Kosova për SHBA-të. I kritikuar nga politika, media por edhe publiku, Rusia e ndërmori aksionin për shkëputjen e Krimesë pas



konsensusit unanim që buroi prej referendumit që zhvilloi atje, duke i treguar botës perëndimore se kjo nevojë vinte prej njerëzve. Nga ana tjetër, Rusia nëpërmjet shkëputjes së njëanshme të Krimesë nga Ukraina, tentoi të ripozicionojë rolin e saj strategjik në rajon dhe i tregoi SHBA-ve dhe aleatëve të saj se, nëse këta të fundit janë të legjitimuar të marrin një vendim të njëanshëm, po aq të legjitimuar janë edhe të tjerët, Rusia në këtë rast, ta bëjnë këtë veprim, duke u kujtuar shprehjen romake "Quod licet Jovi, non licet Bovi" (çka është e lejuar për Jupiterin, është e lejuar për Buallin).

Dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka qenë një vendimmarrje pa kosto për shtetet evropiane, referuar

ritmit intensiv të përpjekjeve, protestave e referendumeve për shpallje pavarësie, të gjitha nën precedentin Kosovë. Tashmë, kjo e fundit prezanton kërkesën e radhës, e cila ka shqetësuar diplomacinë ndërkombëtare, pikërisht për shkak të turbulencave gjeostrategjike e politike që mund të shkaktojnë. Mund të jetë legjitime kërkesa e Kosovës për të përmbyllur çka lidhet me pavarësimin e plotë, por në aspektin politik, kjo nis e përcaktin fillimin e një faze të re nërsa e përket ecurisë së zhvillimeve në rajon si edhe mënyrës se si shtetet përcaktojnë pushtetin e forcën e tyre gjeopolitike në rajonet e botës.

Krijimi i shtetit të Kosovës është mbështetur fuqishëm nga SHBA-të,

pjesa më e madhe e vendeve evropiane dhe mediat e tyre, të cilat e parashtruan konfliktin tek opinionin publik. Nga ana tjetër, lufta mediaticke që ndërmori Putin për të legjitimuar aksionin e tij në Krime, në fakt lëkundti legjitimitetin mbi bazën e të cilit u krijua shteti i Kosovës. Propozimi dhe parashtrimi i çështjes për rishikimin e kufijve bëhet në këtë terren paksa skeptik dhe kontravers për Kosovën. Ky propozim përveçse ngre paqartësi mbi të ardhmen e situatave që janë shpalosur në Evropë e më gjerë, gjithashtu tregon tendencën e fuqive të mëdha për të përforcuar pushtetin strategjik, duke theksuar gjithnjë e më shumë ndarjet mes tyre. Kosova ka pasur gjithnjë mbështetjen e

SHBA-ve dhe po kështu, edhe Serbia atë të Ruisë, moment ky që e bën paksa delikate situatën. Mediat respektive po njësoj kanë treguar këtë tendencë. Raportimet, komentet, intervistat apo analizat që prodhoi ideja e rishikimit të kufijve parashtronin mundësinë që shkëmbimi i kufijve jo vetëm që do të sillte destabilitet në botë, por do të kishte impakt negativ në ambicjet strategjike të fuqive të mëdha. Për mediat perëndimore, shqetësimi më i madh që parashtronte këtu lidhet me "armikun" e saj të përhershëm, që është Rusia dhe pretendimet e saj për të kontrolluar territoret në shtetet që kanë mazhorancë etnike ruse. Mediat perëndimore kanë parashtruar analiza që e konsiderojnë këtë situatë si kërcënuese, referuar edhe qëllimeve strategjike të Ruisë në botë, ndërsa mediat ruse, si "Sputnik", në artikujt e tyre kanë theksuar faktin që Kosova nuk është njohur nga disa shtete si Rusia, Kina, Greqia, Spanja, edhe Serbia etj.

Përveçse faktit që raportimi i mediave reflekton politikat e vendeve nga ato burojnë, në një optikë strategjike, ato përdoren nga faktori politik për të matur pulsionin e opinionit diplomatik e publik dhe për të njohur qëndrimin e tyre mbi çështjen që lançohet. Kjo njohuri e grumbulluar mund të shërbejë për të përgatitur argumente dhe ndërthurur strategjinë për të mbrojtur kauzën dhe në këtë rast, kjo mund t'i shërbejë Kosovës për ta pozuar propozimin e saj në një frymë që gjeneron sa më shumë logjikë politike dhe konsensus ndër aktorët ndërkombëtarë. Po njësoj i rëndësishëm dhe me vlerë është ky moment për palën serbe, e cila ishte e para që e parashtroi idenë e ndarjes. Në një mendim konspirativ, kjo çështje nuk mund të merrte vëmendje më të madhe mediaticke nëse nuk do të lidhej me një vend që gjeneron lajm për shkak të kontraversalitetit dhe sensibilitetit që ajo prezanton dhe Kosova është një rast i tillë. Dhe ndoshta, përfshirja e këtij diskursi në axhendën mediaticke më shumë mund t'i ketë shërbyer Serbisë dhe presidentit Vuçiq, i cili vazhdimisht kërkon këshilla nga presidenti rus Putin.

Gjithsesi, ajo që është e qartë, është se media sot nuk raporton thjesht lajmin, por ajo është një mekanizëm i strategjisë diplomatike më i rëndësishëm sesa komunikimin e drejtpërdrejt politik. Është e qartë se bota po ndryshon, po ndryshojnë edhe dimensionet e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes aktorëve në politikën e jashtme, ku media po merr një rol të rëndësishëm, arsye për të cilën gjërat në diplomaci duhet të fillojnë e të shikohen ndryshe.

Autore e librit: "Get the media - Conspiratoria approach for international media consumption. Crimea and Kosovo"

Opinion **i** Ditës

# Rrëshqitja fiskale, pakt me djallin?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... ditë më parë nga Agjencia Ndërkombëtare "Standard & Poor's" e vlerësimit të kredive për ekonomi shtetërore dhe kompani të mëdha private ishte mirëfilli shumë pozitive. Por, për herë të parë pas 9 viteve që kjo agjenci vlerëson ekonominë tonë, në tërësi pozitivisht, festën e ditiravebeve qeveritare e prishi një frazë e pazakontë në fund: "Ne mund të ndër-marrim një veprim negativ të vlerësimit, nëse vëzhgojmë rrëshqitje fiskale materiale, që rezultojnë nga deficite më të larta fiskale, ose materializim të detyrimeve kontingjente nga projektet PPP...". Gjithnjë kjo kompani, sikurse edhe "Moody's" (kompania tjetër e madhe ndërkombëtare e vlerësimeve) është shprehur në fund se, "ne mund të ulim vlerësimin"... Por asnjëherë "ne mund të nxjerrim një vlerësim negativ". Çdo të thonë këto fjalë-helm, në një gjuhë më të kuptueshme për qytetarin? Rrëshqitja fiskale nënkupton që ti si qeveri detyrohesh të ngresh sa s'mban më borxhin tënd publik nga të ardhurat më të pakta që vjel, ose nga pagesat e rritura vërtet nga koncesionet dhe partneritetet publik-privat dhe... rrëshqet! Pra, këmbët nuk të mbajnë. Askush më nuk të jep borxh në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, sado që të kërkosh. Qeverisë sonë dhe vendit tonë, Shqipërisë, këtë situatë nuk do t'ia uronim kurrë. Por ja që kompania më me emër e vlerësimit të nivelit të borxheve në botë, "Standard & Poor's" paralajmëron për një skenar të tillë. Përse? Askush nuk sulmon Partneritetin Publik-Privat si formë për të investuar në një të mirë apo shërbim publik, duke përdorur paratë të privatit, ngaqë shteti në atë moment mund të mos ketë fonde mjaftueshme. Por kur kjo formë me aq shumë probleme në vetë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian shndërrohet në një lumë të rrëmbyeshëm nga uo dalin, të shtrira në kohë, paratë e Buxhetit tonë të Shtetit (pra paratë të gjithëve, për shembull, projekti 1 miliard euro investime publike i qeverisë sonë që po materializohet këtë vit), atëherë formula aq e kritikueshme në tërësi BE-në e zhvilluar mund kthehet në makth tek ne. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), në 6 mars 2018, në një veprim të pashoq më parë kërkoi nëpërmjet Shefit të Misionit të tij në Tiranë ndalimin e pranimit nga qeveria jonë të ofertave të pakërkuara. Këto oferta janë kur një biznes i kërkon qeverisë një koncesion apo Partneritet Publik-Privat (PPP), pa e hedhur ajo më parë në ankand. FMN kërkoi pezullimin e përkohshëm të koncesioneve jopërkohshme. Të njëjtën gjë e bëri dy javë më vonë, më 20 mars 2018, ambasadori i Lu, një institucion i fjalës së lirë dhe së vërtetë tek ne. Pezullimin e përkohshëm të koncesioneve dhe Partneriteteve Publik-Privat, për t'i dhënë kohë diskutimit të gjerë dhe profesional për to, e kërkoi me forcë



edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ("Për zbatimin pa kushte nga qeveria të rekomandimeve të FMN-së", Bujar Leskaj, shkrimi tek "Gazeta Shqiptare", 31 mars 2018). Ndërkohë që pezullimi i përkohshëm i tyre dhe rishikimi i qasjes me koncesionet dhe PPP-të kërkohet nga auditimi i jashtëm publik i vendit, nga FMN, Banka Botërore dhe Ambasada Amerikane, qeveria mendoi të mos kthente përgjigje, por të vepronte. Deri në mesin e korrikut 2018, ajo u dha kompanive private katër koncesione 13-vjeçare jotransparente (për tipin dhe përmbajtjen e kontratave të tyre dihet shumë pak): Rruga e Arbrit, rruga Thumanë-Kashar, rruga Milot-Balldren dhe rruga Orikum-Dukat, me një kosto të përgjithshme rreth 712 milionë euro. Por cilave kompani? Në mes tyre nuk ka asnjë investues strategjik të huaj, kompani e njohur gjermane apo amerikane, për shembull. Por a u zhvilluan procedurat e tenderit për këto koncesione të hapura dhe korrekte? Për këtë flet në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë raportit i Departamentit Amerikan të Shtetit i datës 29 korrik 2018, për klimën e investimeve tek ne. "Përdorimi në rritje i kontratave të Partneritetit Publik Privat (PPP) ka ngushtuar mundësitë për konkurrencë, përfshirë edhe investitorët e huaj, në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë. Analizat e dobëta kosto-përfitim dhe mungesa e ekspertizës teknike në hartimin dhe monitorimin e kontratave PPP janë shqetësime të vazhdueshme", thotë ky raport. Është shumë i drejtëpërdrejtë. Ndryshe nga qëndrimi i politikaneve evropianoperëndimorë, madje edhe i atyre gjermanë, që është disa i kujdesshëm kur flitet

për interesat investuese të kompanive private të vendeve të tyre në vendet e rajonit. Amerikanët flasin troç. Dhe kjo na ndihmon në qytetarëve të këtij vendi, ku qeveritë tradicionalisht kanë qenë shumë pak transparente për koncesionet që kanë dhënë, për të mos u përballur me llogaridhënien publike, të kuptojmë lojën e qeverisë sonë. Na duket se ajo po luan një lojë të rëndë. Praktikisht po luan me djallin. Po pse? Sepse mungesa prej disa vitesh tashmë e pjesëmarrjes së kompanive me emër perëndimore në projektet tona të infrastrukturës ngre një pikëpyetje të madhe. Dikush mund të thotë se "po mirë, kompanitë tona vendëse ndërtuese janë konsoliduar dhe i fitojnë tenderat ato". Sa mirë do të ishte të kishitë genë vërtet kësh-tu! Mirëpo, raportit i Departamentit Amerikan të Shtetit i datës 29 korrik 2018 tregon një situatë shumë më të rëndë. "Investitorët raportojnë shqetësime të vazhdueshme, pasi rregulluesit e shtetit në Shqipëri përdorin legjislacionin dhe rregulloret e vështira për t'u interpretuar, si mjete për të dekurajuar investitorët e huaj dhe për të favorizuar kompanitë e lidhura me politikën", thotë ai. Një fjalë e urtë e mendësisë anglo-saksone të respektimit të kontratave thotë "Djali i fshihet në detaje". Janë pikërisht detajet që nuk dalin kurrë nga kontratat që lidhen, që na shtyn si qytetarë të dyshojmë se qeveria vërtet po luan rëndë. Po e paralajmëron KLSH, FMN, Banka Botërore, Ambasada Amerikane këtu, "Standard & Poor's" me vlerësimin e saj vjetor Praktikisht, të gjithë ata që janë profesionistë dhe ia duan të mirën. Kanë të drejtë ata, apo qeveria që vazhdon me programin

e saj të koncesioneve dhe PPP-ve që mund të rezultojnë shumë problematike? Ndoshta dikush prej nesh mund të shprehë: "Po ne çfarë na duhet kjo lojë në kupolë? Le të hanë kokën e njëri-tjetrit!". Na duhet dhe na duhet shumë. Sot si qytetarë paguajmë rreth 420 milionë euro më shumë taksë se pesë vite më parë, pikërisht për shkak të këtyre 200 koncesioneve dhe kontratave PPP, që Departamenti Amerikan i Shtetit thotë se deri në fund të vitit 2017, qeveria jonë i ka dhënë (kemi pasur dhe kemi qeveri që nuk lodhen kurrë që të na raportojnë ndonjëherë sa koncesione dhe PPP kanë dhënë, si dhe cilat janë përfitimet e deritanishme dhe kostot për qytetarët). Dimë vetëm që gjatë vitit 2017, për shembull, Buxhetit tonë të Shtetit, për një kontroll shëndeti "Check-up" që çdo qytetar duhet ta marrë falas, iu desh t'i paguajë koncesionarit privat 84% më shumë se çmimi i check-uarit në kontratë, pasi "Check-up" falas gjatë vitit të kaluar kreu vetëm 67% të kontrolleve të programuara dhe këtë vit duket akoma dhe më keq. Akoma mendoni se nuk po dalin në dritë brirët e djallit? Me koncesionet dhe PPP-të e reja që po jepen lumë, sipas edhe përlogaritjeve të FMN-së, i bie që në katër vitet e ardhshme, deri në fund të vitit 2021, të paguajmë edhe rreth 250 milionë euro të tjera më shumë, në formën e taksave të shtuara, për të përballuar kështu e pagesave të këtyre investimeve të reja që shlyhen për 13 vite. Prandaj duhet t'i mbajmë sytë hapur si qytetarë dhe opinion publik, pse qeveria jonë duket se gjithçka po bën, por jo që të na informojë me korrektesë dhe hapur për lëvizjet e saj me rrezik të lartë rrëshqitjeje.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Sjellja juaj plot xhehozi mund t'ju bëjë të trishtuar dhe depresiv. Por ky është një dëm që i bëni vetes, kështu që nuk ka nevojë të qani për këtë. Motivi veten që ta largoni këtë problem duke ndarë gëzimin dhe hidhërimin e tjetrit.

**DEMI**  
Sot do të ndiheni të lodhur dhe ka të ngjarë të jeni të merrtur për çështjet të vogla. Sjellja jo e mirë ndaj partnerit tuaj të jetës mund të dëmtojë marrëdhënien. Kaloni kohën dhe rigjallëroni kujtimet tuaja të ëmbla për të rifituar ditët e të lumtura.

**BINJAKET**  
Një rritje në përgjegjësi duket e mundshme në aspektin profesional. Shmangni tejkalimin e shpenzimeve nëse shkoni për pazar. Ndërkohë, në aspektin romantik mund të keni disa mormarrëveshje, por brenda kufijve të normale.

**GAFORJA**  
Zakoni që keni për të ruajtur energjinë do të jetë diçka pozitive sot, veçanërisht për shëndetin. Mund të ndodhë një udhëtim i shkurtrë, por jo si diçka pozitive. Edhe marrëdhënia e dashurisë nuk do të jetë në formën më të mirë.

**LUANI**  
Bëni përpjekje serioze për të përmirësuar personalitetin tuaj. Përfshirja e vetes në një grup të madh do të jetë shumë argëtues, por shpenzimet do t'ju marrin një trend të lartë. Sot në shtëpi duhet të përqendri mos hjeni të tjerët dhe të përshatani me nevojat tuaja familjare.

**VIRGJERESHA**  
Mendoni vetëm pozitivisht, në mënyrë që të jetë i kaloni çdo situatë që ju del përpara. Edhe shpenzimet do të rriten, por kjo nuk do të përbëjë problem, sepse situata financiare parashikohet të jetë e mirë për ju.

**PESHORJA**  
Dikush mund të shqetësojë rehatinë tuaj, por mos lejoni që të bëni presë e askujt. Këto shqetësime të panevojshme mund të kenë ndikim në trupin tuaj dhe të shkaktojnë probleme. Kontrolloni shpenzimet.

**AKREPI**  
Burime të reja të të ardhurave do të gjenerojnë nëpërmjet njerëzve që njihni. Do të keni atë energji ekstra që t'ju bëjë të organizoni ngjarje për miqtë tuaj. Mund të merrni komplotime në punë.

**SHIGJETARI**  
Sjellja juaj do të vlerësohet. Shumë njerëz do të shprehin më fjalë pozitive për ju. Paratë e tepërta duhet të investohen në pasuri të paluajtshme. Një ditë e favorshme për çështjet familjare.

**BRICJAPI**  
Meditimi dhe vetërealizimi do të jenë të dobishme. Disa marrëveshje mbi pronat do të materializohen dhe do të sjellin përfitime të shkëlqyera. Çështjet e brendshme kërkojnë vëmendje të menjëhershme.

**UJORI**  
Sot ju do të keni kohë të mjaftueshme për të bërë gjëra që ju përmirësojnë shëndetin. Ndërkohë, shëndeti i një personi të moshuar në familje mund të shkaktojë stres. Jeta juaj e dashurisë do të marrë një kthesë të bukur sot.

**PESHQIT**  
Do të keni rritje shpenzimesh, që do t'ju shkaktojnë ankth. Neglizhenca e shëndetit të prindërve nga ana juaj mund të jetë e rrezikshme dhe zgjat sëmundjen e tyre. Disa mundësi të mira kanë të ngjarë t'ju vijnë, nëse qëndroni menjëhapur.

ALUIZNI: Përfituesit të paraqiten në ZVRPP për regjistrimin e objektit të legalizuar

Hipoteka, 300 pronarët që kanë gati tapitë

Lista me përfituesit në Shkodër, Malësi të Madhe dhe Pukë

Ornela Manjani

Drejtorja Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër gjithë qytetarët që gjejnë emrin në listë të paraqiten pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (ZVRPP Shkodër) dhe Zyrës Vendore të

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe (ZVRPP Malësi e Madhe) për të aplikuar për regjistrimin e pasurive të tyre dhe pajisjen me certifikatë pronësie. Janë në total 300 përfituesit në garkun Shkodër.

TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë,

por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijonë për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që

sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqesë bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për

ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt)

kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të deponituar brenda afatit të vetëkëllimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përpunet vullneti.


PRONARËT QË KANË GATI TAPITË

Table with 6 columns: Nr, Emri, Adesi, Mbiemeri, Ujeje Legalizimi, Vendodhja, Zk. Lists property owners in Shkodër, Malësi të Madhe, and Pukë.

Table with 6 columns: Nr, Emri, Adesi, Mbiemeri, Ujeje Legalizimi, Vendodhja, Zk. Lists property owners in Shkodër, Malësi të Madhe, and Pukë.

Table with 6 columns: Nr, Emri, Adesi, Mbiemeri, Ujeje Legalizimi, Vendodhja, Zk. Lists property owners in Shkodër, Malësi të Madhe, and Pukë.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- O Toole aktor
- Si vizuale.
- Në fund të lutjes.
- Janë popullsi e dytetit
- Një pije freskuese.
- Eshtë enjtie.
- Teke prize.
- Janë mallkime shkishëruese.
- Një aftësi paranormale.
- Janë fakultetet më me leverdi.
- Gjëja e romakëve.
- Thahen me bonifikim.
- Zemecickis regjisor
- Janë në temë
- Inicialet e Harris aktor.
- Eshtë figurë gjeometrike.
- Një markë makine qepëse.
- Kush ka... ka zët.
- Mbyllin komentin.

- I bëhen të gjitha mikut.
- Një version i dikurshëm i FIAT.
- Fillojnë shkurt.
- Një pikë në ligj.
- Inicialet e Morricone-s.
- Të fundit në manastir.
- I ka kërcyer të xhindosurit.
- Janë pjesë të dramës

**VERTIKAL**

- Fillojnë panikun.
- Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
- Në krye të tenorëve.
- Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
- Inicialet e Anka këngëtar.
- Kush ka... ka nevojë për gjak
- Ndiqet ajo e fundit
- Duken të gjata në pritje.
- Një fazë gjumi.
- Shteti i francezëve
- Një art i shtatë.
- Eshtë pellgu.
- Shkroi Pa familje
- Janë dokumente shtëpie.
- Eshtë filmi që mallëngjen.
- Një kolegji anglez.
- Janë baballarët.
- Mund të jetë elektrike.
- Eshtë hidrofobi.
- Ajo e forcës është për të çmendur.
- Kremi pa ekstreme.
- Si sezonale.
- Mund të jenë unike
- Mund të jenë periodike të tilla.
- Eshtë bishë që zgërdhahet.
- Fillojnë nazet
- Inicialet e Diamanti aktor.
- Eshtë mosha më e bukur.
- Fillojnë temën.
- Kufizojnë një send.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Një film publicitar
- Në krye të bashkisë
- Me Romeo në makinë
- Në fund majtas
- Janë kompozime si Vejusha gazmore
- Janë në masë.
- Janë melodrama.
- Fillojnë dobët.
- Në hyrje të radios.
- Një pjesë e lipotimisë.
- Eshtë gjendje të fikti.
- Eshtë vërtet i mërztitshëm.
- Malden që këndojnë
- Hurley aktore.
- Pak torturuese.
- Ekstreme në tunel.
- Ndezur në aparaturë.
- Ai i shenjtë është papa.
- Merrte fuqi nga toka.
- Pak enigmatike.

**VERTIKAL**


- Qe mbreti i parë i Izraelit.
- Post scriptum
- Një sferë... për model.
- Eshtë infeksion në bark
- Një mund të jetë arme.
- Në krye të atletëve.
- Eshtë grimcë me bërthamë.
- Ishtë sundimtar si Tutankamon
- Masat pa kufij
- Një sport baskësh
- Janë marrëdhënie.
- Padia pa kufij.
- Eshtë në minorancë.
- I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
- Kështu janë lojtarë te formaconit
- Janë të holla dhe therëse.
- Makinë ruse.
- Eshtë dita e dytë
- Bisha aktore.
- Në mes të rrugës.
- Një trup pa kënde.
- Satie kompozitor.
- I ka të ndryshme një sakat.
- King Cole i muzikës.
- Inicialet e Penn aktor.
- Në mes të dhomës.
- Të fundit në spital.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

				7					
2		4		3		7	1		
			6	9					5
		3	7	6	8				
	5		9						
8	1		5	2			9	3	
				6					2
	7	1							9
6									

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	1	3	6	8	4	7	9	5
4	8	9	7	3	5	6	1	2
5	6	7	9	1	2	8	3	4
1	2	8	4	5	6	9	7	3
3	4	6	1	9	7	2	5	8
9	7	5	3	2	8	1	4	6
7	9	2	5	6	3	4	8	1
6	5	1	8	4	9	3	2	7
8	3	4	2	7	1	5	6	9

*Argëtim filozofik*

- Askush nuk i është mirënjohës njeriut me shpirt të madh për mirësjelljen e tij, kur ky i përshatet një shoqërie ku nuk është e sjellsme të tregosh se ke shpirt.
- Pa ambicie, asgjë nuk fillon. Pa punë, asgjë nuk përfundon.
- Nëse bashkëshortët nuk do të jetonin së bashku, martesat e mira do të ishin më të shumta.
- Mirësia e një martesë provohet me këtë, që ajo lejon një herë një "përjashtim".

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

15D	1	7	2	3	1	4	2	17	6	2	4	I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T		
6O		2	3	10		11		17	4	9	3	2	B	E	L	A	M	I	S	R	N	I		
17B	7		8	6	9	6	13	4	6		17	7	I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
7I		11	7	2	6	1	4	2		2	4	8	Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
	8	6	12	4	13	2	4	2		4	9	4	A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
18	3	1	4	12		4	1	4		1	3	2	A	R	I	T	I	U	I	T	A			
2	3	12	2	3	12		3		16	1		3	A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
	16	3							16	2	7		K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
15		2	4	8	16	2			12	7	2	4	2	T	K	D	E	T	E	A	N	T	A	
4	18		1	1	7		8	7	9	6	13	7	U	N	I	O	N	M	R		T	K		
12	7	1	7	3	12		8	1	4	1	4	2	A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
7	2	3		10	7	3		3	2	7		6	L	K	S	T	U	R	I	S	T	E	T	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M A R I E K O H A A K  
 F I L L I D O M A T E R  
 R A F T M I M R S E  
 A A P E R I P A T I S E  
 Z E M E R A K E T S T I  
 F I D A N E T V E T E M  
 S E N T I T B E R T K E  
 S E N T E K A L L A P A T  
 T R E E L S A T T  
 L I V E T I V K A A D  
 N A A R N J E A P E L  
 D A L A I V A K A N T E  
 E D E N P N A D I A M  
 R R E M I R E T T R I O  
 T E S T R T A T E O L  
 S M N O T A R E T N L  
 K A A M E R I K A N L  
 E H P A M A D S H  
 K O L O N A O T E C E  
 T U N E L E T P E R O S  
 O R A I T K E S T I A T  
 K A N S A R A H E P  
 E T J A C I T A T E T I

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Kur lidhet një martesë duhet bërë kjo pyetje: a beson ti se mund të bashkëbisedosh mirë me këtë grua deri në pleqëri?
- Gjithë sa mbetet nga martesë është kalimtare, por koha më e madhe e jetës së përbashkët i përket bashkëbisedimit.
- Pak njerëz kanë në natyrë këtë: të nderojnë pa zili mikun e tyre të lumtur.
- Fuqia e fatit është e njohur vetëm nga të dështuarit, sepse të suksesshmit i atribuojnë gjithë suksesin e tyre vetëm maturisë dhe vlerës së tyre.

